



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 15 regjistër (JR)  
Datë 31.03.2021

Nr. 50 i vendimit  
Datë 21.11.2023

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Ina Rama</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Relatore</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 21.11.2023, ditën e martë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Arben Allajbeu, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 334, datë 14.01.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b i Kushtetutës, neni F i Aneksit të Kushtetutës; neni 6 dhe neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 1, 2, 63 dhe neni 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Kodi i Procedurave Administrative; Kodi i Procedurës Civile; ligji nr. 49/2012 “Për ngritjen dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e paraqitura në ankim dhe në parashtrime nga subjekti i rivlerësimit Arben Allajbeu,

i cili kërkoi çeljen e shqyrtimit gjyqësor, ndryshimin e vendimit nr. 334, datë 14.01.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoji gjyqtaren relatores Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për këtë arsye, bazuar në nenin 179/b, pika 3 të Kushtetutës, ai i është nënshtuar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* nga Komisioni.
2. Bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 e 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

2.1 Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, referuar deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit *vetting*, i dërgoi Komisionit raportin përfundimtar, duke konstatuar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për burimin e pasurive në pronësi dhe në përdorim nga subjekti*; (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë*; dhe (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

2.2 Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, pas procedurës së kontrollit të kriterit të figurës, konstatoi *papërshtatshmërinë* e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës.

2.3 Këshilli i Lartë i Prokurorisë i dërgoi Komisionit raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar, pasi kreu procedurën përkatëse të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale.

### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Me vendimin objekt shqyrtimi, pasi kreu procesin e rivlerësimit për të tri kriteret, Komisioni vendosi të shkarkojë nga detyra subjektin e rivlerësimit. Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës: **(1)** nuk ka deklaruar saktë pasuritë në përdorim dhe në pronësi; **(2)** nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave; dhe **(3)** është përpjekur të fshehë këto pasuri. Për këto konstatime, sipas vlerësimit të Komisionit, subjekti nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, që e vendosin në kushtet e pikës 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, lidhur kjo dispozitë me pikën 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, përbën shkak për shkarkimin nga detyra.

### III. Shkaqet e ankimit

4. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ankim kundër vendimit të Komisionit duke kërkuar nga Kolegji: (i) gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike; (ii) riçeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin e provave të reja; (iii) konstatimin e shkeljes së Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”); (iv) prishjen ose ndryshimin e vendimit të Komisionit; dhe (v) konfirmimin në detyrë. Argumentet e subjektit, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijojnë:

#### 4.1. Në lidhje me procesin e rregullt ligjor

- (i) Është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e krijuar me ligj. Sipas subjektit, anëtarët e trupit gjykues të Komisionit [znj. Pine, znj. Çiftja dhe znj. Qirko], nuk plotësojnë kushtin e vjetërsisë në punë, parashikuar në germën “b”, të nenit 6 të ligjit nr. 84/2016.
- (ii) Është cenuar parimi i procesit të rregullt ligjor nëpërmjet një hetimi të plotë e të gjithanshëm. Sipas subjektit, vendimi është marrë mbi bazën e një hetimi dhe vlerësimi administrativ të paplotë.
- (iii) Komisioni nuk i ka bërë me dije se nga cilat prova ka nxjerrë të dhënat apo konkluzionet e pasqyruara në analizën financiare dhe identitetin e personit që ka kryer analizën financiare, përgjegjësitë apo kualifikimet e tij. Komisioni nuk e ka njohur me analizën e re financiare që kreu, pasi subjekti paraqiti prova për të përmbysur rezultatet e hetimit.
- (iv) Gjatë hetimit të zhvilluar në Komision, i është mohuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e drejta për t’u mbrojtur dhe dëgjuar në mënyrë efektive dhe të drejtë, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, duke shkelur edhe parimin e barazisë së palëve, arsyetueshmërisë e vendimit, por edhe atë të kontradiktorialitetit.
- (v) *Sa i takon analizës së viteve 2017-2018*, është cenuar procesi i rregullt ligjor, pasi hetimi tej afatit të përcaktuar nga ligji përbën mungesë arsyetimi, cenim të pavarësisë së gjyqësorit dhe tejkalim kompetencash, pasi kontrolli tej procesit të rivlerësimit kryhet nga KLP/KLGj.

#### 4.2. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë

4.2.1. *Për apartamentin në Durrës*, subjekti kërkon që të konsiderohet si burim krijimi kredia nga Alpha Bank. Po ashtu, sipas tij, z. E. K. nuk mund të merret si person tjetër i lidhur, për shkak të deklaratës së borxhit të dhënë për blerjen e shtëpisë.

4.2.2. *Për huan në vlerën 10.000 euro dhënë motrës, në vitin 2014*, subjekti kërkon:

- (i) Të përfshihen të ardhurat e tij nga puna në vitet 2001-2004, të ardhurat e bashkëshortes nga puna që prej vitit 2002, “të hollat nga martesat” në vitin 2005 dhe dhuratat (të holla) për lindjen e fëmijëve në vitet 2006 dhe 2010.
- (ii) Të mos përfshihen në analizë shpenzimet e preventivit të punimeve për apartamentin në Durrës, i hartuar nga sipërmarrësi në vitin 2007, në vlerën 5.000 euro.
- (iii) Të ulen shpenzimet jetike në vlerën 136.620 lekë për vitin 2007, dhe jo 235.968 lekë, meqenëse familja e tij ka jetuar në Berat. Njëkohësisht, subjekti parashtron se shlyerja e kredisë nga viti 2007-2014 është bërë nga i ati e, për pasojë, vlera përkatëse nuk duhet t’i ngarkohet atij si shpenzim.

4.3. *Për huadhënien prindërve në vlerën 7.000 euro, në vitin 2016*, subjekti kërkon:

- (i) Të përfshihen në analizën financiare edhe të ardhurat/diferenca midis çmimit të shitjes dhe atij të blerjes së automjetit tip BMW, në masën 161.310 lekë dhe fitimi nga shitja e automjetit tip “Fiat Punto”, në masën 50.000 lekë.
- (ii) T’i zbriten shpenzimet për fëmijët nga shpenzimet e jetesës, pasi kanë pasur të përfshirë në pagesën e shkollës edhe ushqimin.

#### 4.4. Për apartamentin në Tiranë, në pronësi të vjehrrës

(i) Është paragjykuar çështja/analiza për shkak të denoncimit. Denoncimi anonim nuk ka vlerën e provës as të indicies për provë në proces, sepse denoncuesi nuk mund t'i nënshtrohet kontradiktorialitetit.

(ii) Fakti që ai ka deklaruar përdorimin e kësaj prone dhe fakti që vjehrra nuk ka banuar në Tiranë, nuk krijon dyshim për fshehje pasurie. Vjehrra e subjektit ka rezervuar dy vende parkimi, në Tiranë dhe në Berat, ndonëse nuk disponon automjet, meqenëse parkimi në Tiranë është *fenomen shqetësues*. Porositja e parkimit lidhet me faktin se kjo pasuri është blerë për të birin (kumatit e subjektit) që jeton në Itali. Apartamenti është krijuar me të ardhurat e kumatit nga emigracioni, nga shitja e shtëpisë së vjehrrës në Berat dhe nga kursimet e vjehrrës. Vjehrra dhe kunati nuk mund të merren si persona të tjerë të lidhur.

#### 4.5. Për përdorimin e banesës së prindërve në Berat

(i) Prindërit nuk janë “persona të tjerë të lidhur” për faktin se subjekti ka jetuar në shtëpinë e tyre.

(ii) Të ulet vlera e shpenzimeve për ndërtimin e katit shtesë të kësaj pasurie, nga 3.831.600 lekë, në 2.000.000 lekë.

(iii) Të përllogariten të ardhurat nga aktiviteti i nënës si shitëse ambulante për vitet 2004-2012, nga 131.478 lekë në 616.934 lekë.

(iv) Mënyra e përllogaritjes së shpenzimeve të jetesës nga Komisioni është e gabuar, pasi transporti gjatë periudhës së punësimit është llogaritur dy herë.

(v) Shpenzimet e jetesës për vitin 2015 janë dy herë më të larta sesa ato të referuara nga ILDKPKI-ja. E njëjta frymë, sipas subjektit, është për të gjithë vitet.

4.6. Për sa më lart, subjekti kërkon që ankimi i tij të analizohet nën dritën e parimit të proporcionalitetit, duke qenë se diferenca del në vlerën (-) 590.231 lekë, që nuk mund të përbëjë shkak për shkarkim nga detyra.

4.7. Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar saktë deklaratën *vetting* - rreth gjendjes *cash deklaruar* në vlerën *900.000 lekë* -- nuk mund të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, pasi këto pasaktësi nuk janë shoqëruar me përpjekje për fshehje pasurie.

4.8. Nuk gjendet në kushtet e deklaramit të *dyfishit* të pasurisë së ligjshme. Thelbi i dispozitave të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, sipas subjektit, ka të bëjë me deklaramin e rremë dhe fshehjen. Për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, duhet të plotësohen në mënyrë kumulative pamjaftueshmëria e kontrollit të figurës dhe kriteri i pasurisë, në të kundërt shkelet neni 8 i KEDNj-së.

5. Në datën 15.11.2023, subjekti paraqiti parashtrimet e tij përpara seancës, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim referuar si “ligji nr. 49/2012”). Trupi gjykues vëren se këto parashtrime nuk paraqesin rrethana apo pretendojnë fakte të ndryshme nga ato të paraqitura në ankim. Për rrjedhojë, edhe këto argumente janë pjesë e analizës së kryer për shkaqet e ankimit.

#### IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

##### A. *Mbi aspektet procedurale të gjykimit*

###### a) *Juridiksioni i Kolegjit*

6. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, për rivlerësimin subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim që ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

###### b) *Legjitimimi i ankuesit*

7. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

###### c) *Forma e shqyrtimit të ankimit në Kolegj*

8. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në Kolegj, kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit. Përrjashtim bëjnë rastet kur trupi gjykues gjen se plotësohen kriteret e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 334, datë 14.01.2021, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në dhomë këshillimi.
9. Subjekti ka bashkëlidhur me ankimin pesë (5) akte shkresore<sup>1</sup> dhe ka shtuar se mund të paraqesë prova, të cilat për shkaqe objektive apo për shkak të kufizimeve të krijuar nga gjendja e pandemisë nuk ka mundur t'i paraqesë bashkëlidhur ankimit. Pasi i analizoi këto akte nën dritën e parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e të njëjtit ligj, trupi gjykues i Kolegjit vendosi të mos pranojë asnjë prej tyre. *Së pari*, trupi gjykues thekson se vëren se këto akte nuk kapërcejnë pragun ligjor të vendosur nga ligj për provat e reja në ankim, në kushtet që subjekti nuk ka argumentuar se cili ka qenë shkaku që i ka krijuar pengesën apo pamundësinë e paraqitjes së provave gjatë hetimit administrativ në Komision, sipas kriterëve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012<sup>2</sup>.

<sup>1</sup> Aktet e sjella nga subjekti bashkëlidhur ankimit janë: (i) shkresë e Avokatit të Popullit, datë 03.03.2017, që përcjell dokumentacionin në Kuvend, përfshirë edhe atë mbi komisioneret anëtare të trupit gjykues që kanë kryer rivlerësimin e tij [subjektit] në Komision; (ii) shkresë e Bashkisë Berat, datë 11.03.2021, nëpërmjet të cilës subjekti kërkon të provojë të ardhura të nënës nga aktiviteti si Person Fizik tatimpagues (ambulant); (iii) vërtetim datë 08.03.2021, nga institucioni arsimor jopublik ku kanë studiuar fëmijët e subjektit [shkolla “{\*\*\*}”, Berat], në të cilën pasqyrohen të dhëna për shërbim falas të përfutuara prej tyre për arsimim, transport edhe dy vakte ushqimore; (iv) librezë furnizimi me energji elektrike, për një kontratë të lidhur në mars 2020; dhe (v) faturë tatimore shitjeje, datë 16.07.2020, për mobilimin e apartamentit.

<sup>2</sup> Neni 47 i këtij ligji përcakton që: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

9.1. Përpos dhe duke abstraguar nga analiza e kriterëve për pranimin e provave të reja në ankim, trupi gjykues vëren se nën dritën e parashikimeve të nenit 49, pika 6, germa “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016<sup>3</sup>, këto akte u vlerësuan të panevojshme e të parëndësishme për vendimmarrjen. Konkretisht, nga një verifikim i akteve të dërguara, Kolegji vëren se shkresa e Avokatit të Popullit, nëpërmjet së cilës subjekti pretendon se mbështet argumentet për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme dhe e krijuar me ligj, daton vitin 2017, përpara vendimit objekt ankimi. Kjo nënkupton që për paraqitjen e kësaj prove gjatë hetimit administrativ nuk ka pasur asnjë pengesë. Më e rëndësishmja, argumentet për përjashtimin e ndonjëres prej anëtareve të trupës gjykuese, për shkak të kriterëve të zgjedhshmërisë, nuk janë ngritur në Komision. Nga aktet në fashikull rezultojnë se subjekti nuk ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e anëtarëve të trupës gjykuese në asnjë fazë të procesit në Komision, qoftë edhe nën këndvështrimin e garancive për një trupë gjykuese të paanshme apo të gjykimit nga një gjykatë e krijuar me ligj, në kuptim të nenit 27 të ligjit nr. 84/2016, të nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative dhe të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, në nenet 72<sup>4</sup> dhe 74<sup>5</sup>. Ky pretendim është paraqitur për herë të parë në Kolegji, pas një vendimmarrje në disfavor të subjektit të rivlerësimit. Edhe duke abstraguar nga ky konstatim, subjekti nuk ka identifikuar në ankim apo parashtrime ndonjë situatë njëanshmërie apo rrethana që do të klasifikoheshin në rastet që përbëjnë pengesë ligjore për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit konkludon se duke mos argumentuar shkaqe që pamundësuan paraqitjen e këtij pretendimi në Komision në respektim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, dhe pasi dështoi të bindë Kolegjin për rrethana që do të vlerësoheshin në drejtim të mungesës së paanësisë apo gjykatës që është caktuar me ligj, kjo kërkesë e subjektit u gjet e pabazuar.

9.2. Së dyti, në vijim të jurisprudencës së Kolegjit<sup>6</sup>, bazuar edhe në standardet e elaboruara nga GjEDNJ-ja në çështjet *Astraðsson* kundër Islandës dhe *Cani* kundër Shqipërisë, pretendimi për plotësimin e kushteve të zgjedhshmërisë së komisionerëve është i pabazuar edhe nën këtë kontekst. Një arsyetim i zgjeruar gjen pasqyrim në analizën e pretendimeve të subjektit me natyrë procedurale.

9.3. Subjekti pretendon se shkresa e Bashkisë Berat, e datës 11.03.2021, mbi punësimin e nënës së subjektit [znj. Sh. A.], si tatimpaguese/shitëse ambulante, nuk është paraqitur në Komision, për shkak *pamundësisë objektive* për gjetjen e dokumentacionit, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4<sup>7</sup> e ligjit nr. 84/2016. Nëpërmjet kësaj shkrese, subjekti pretendon se për periudhën përpara se

---

<sup>3</sup> Neni 49, pika 6 e ligjit nr. 49/2012 përcakton që: “[6.] Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme; b) fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit; [...]”.

<sup>4</sup> Neni 72, parashikon: “Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur: [6.] në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie”.

<sup>5</sup> Neni 74, paragrafi II parashikon që: “[...] Kërkesa e nënshkruar nga pala përkatëse ose nga përfaqësuesi i saj, duhet të depozitohet në sekretarinë e gjykatës kur është bërë i ditur emri i gjyqtarit apo gjyqtarëve që shqyrtojnë çështjen dhe në rastin e kundërt menjëherë pas shpalljes së gjyqtarit apo gjyqtarëve që do të gjykojnë çështjen. Paraqitja e mëvonshme e kërkesës lejohet vetëm kur pala ka marrë dijëni më vonë për shkakun e përjashtimit ose kur gjatë ushtrimit të funksioneve, gjyqtari ka shfaqur mendim të njëanshëm e në mënyrë të papërshtatshme mbi faktet dhe rrethanat objekt gjykimi, por sidoqoftë jo më vonë se tri ditë nga marrja dijëni. [...]”.

<sup>6</sup> Vendimi i Kolegjit (JR) nr. 43/2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Hajrie Muçmataj.

<sup>7</sup> 2. Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër.

nëna e subjektit të regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (në vijim “QKB”), tregtarët nuk kanë qenë të pajisur me *NUIS* dhe nuk ka pasur një qarkullim vjetor. Nga përmbajtja e aktit, rezulton se kërkesa për informacione e subjektit drejtuar Bashkisë Berat daton rreth dy muaj pas shpalljes së vendimit nga Komisioni. Në këto kushte, ajo nuk përmbush kriteret e përcaktuara për provat e reja në ankim.

9.4. Për më tepër, informacioni që subjekti përcjell me këtë shkresë nuk është i njëjtë me informacionin që Bashkia Berat i ka dërguar Komisionit në kuadër të hetimit administrativ. Konkretisht, përgjigjja e Bashkisë Berat<sup>8</sup> drejtuar Komisionit referon se nëna e subjektit nuk ka deklaruar qarkullim të të ardhurave dhe në mungesë të këtij veprimi, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave për vitin 2012 dhe 2013 ka vendosur qarkullim sipas parashikimit vjetor 0-2 milion lekë<sup>9</sup>. Nga ajo shkresë, administruar në fashikullin e hetimit administrativ nga Komisioni, rezulton që pretendimi i subjektit në parashtrime se qarkullimi vjetor nuk zbatohet është i pavërtetë. Edhe duke abstraguuar nga ky fakt, të dy shkresat nuk provojnë dhe as nuk përmbajnë indicie për të provuar që nëna e subjektit ka qenë shitëse ambulante përpara vitit 2012, sikurse as nuk provojnë vlerën e të ardhurave të pretenduara nga subjekti apo ndonjë vlerë qoftë edhe të ndryshme. Në këto kushte, ky akt nuk u pranua nga Kolegji, edhe nën dritën e nenit 49, pika 6, gjerat “a” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016, pasi u vlerësua i panevojshëm dhe pa ndikim në vendimmarrje, edhe duke abstraguuar nga ndalesat që vijnë për shkak të pragut të vendosur nga neni 47 i ligjit nr. 49/2012, për provat e reja në ankim.

9.5. Subjekti, po ashtu, nuk arriti të provojë pretendimin e tij për pamundësi objektive për të gjetur dokumentacionin. Ky konkluzion mban në konsideratë, jo vetëm që subjekti nuk provoi dhe as argumentoi humbjen apo pamundësinë e gjetjes së dokumentit, por përkundrazi rezultoi se subjekti në fakt ka qenë në gjendje të marrë informacion në dy raste, ka marrë dy akte nga bashkia, të cilat provojnë që pretendimi i tij se nuk zbatohet qarkullimi nuk është i vërtetë.

9.6. Me një vërtetim të datës 08.03.2021, që rezultoi të jetë e dyta shkresë nga i njëjti institucion arsimor jopublik në Berat, subjekti kërkon të vërtetohet se fëmijët e tij kanë përfituar pa pagesë arsimimin, transportin edhe dy vakte ushqimore. Edhe kjo shkresë daton pas vendimit të Komisionit dhe, ç’është më e rëndësishme, bie ndesh me shkresën e mëparshme, pasi në të referohen përfitime shtesë krahasuar me përgjigjen e mëparshme të administruar në Komision<sup>10</sup> në vitin 2019, sipas së cilës përfitimi i vetëm *pa kundërshpërblim* për fëmijët ishte arsimimi. Me fjalë të tjera, subjekti ka paraqitur dy shkresa me përmbajtje të ndryshme për të njëjtin fakt – shërbimet e përfituara falas – lëshuar nga i njëjti institucion, në dy kohë të ndryshme, përkatësisht gjatë hetimit në Komision dhe pas vendimit të tij. Në shkresën e dytë, përpos arsimit, shtohen edhe përfitime të tjera, në favor të pretendimit të subjektit për ulje të shpenzimeve jetike meqenëse, sipas subjektit, *fëmijët kanë ngrënë vetëm një vakt ushqimor në shtëpi*. Në shkresën e vitit 2019 ishte e specifikuar që fëmijët përfitonin *shkollimin falas*.

9.7. Trupi gjyqës vlerëson se edhe ky akt nuk përmbush kushtet e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012<sup>11</sup> dhe të pikës 6, të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti nuk ka pasur pengesë për të dorëzuar

<sup>8</sup> Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 14.10.2020.

<sup>9</sup> Shkresa e Bashkisë Berat nr. {\*\*\*} prot., datë 22.10.2020.

<sup>10</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 22.10.2019, “Vërtetim”.

<sup>11</sup> Neni 47 - Paraqitja e provave të reja në ankim - parashikon se: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohej prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose

këtë shkresë në Komision. *Së pari*, nga përmbajtja e saj, rezulton qartë një përpjekje për të referuar fakte në favor të pretendimeve të subjektit, pasi është njohur me vendimin e Komisionit. Për rrjedhojë, edhe ky akt nuk u pranua si provë në Kolegj, pasi u gjet i papranueshëm sipas kritereve ligjore dhe i parëndësishëm për vendimmarrjen.

9.8. Ndërsa sa i takon: (i) librezës së furnizimit me energji elektrike, për një kontratë të lidhur në mars të vitit 2020<sup>12</sup>; dhe (ii) faturës tatimore të shitjes [për mobilimin e apartamentit, me datë 16.07.2020], trupi gjykues vëren se këto akte i përkasin ngjarjeve që kanë ndodhur tej periudhës së rivlerësimit dhe pas plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting* e, si të tilla, nuk i shërbejnë procesit sikurse edhe nuk paraqesin ndonjë vlerë provuese në të kundërtën e sa ka konstatuar Komisioni për vlerësimin e kriterit pasuror.

9.9. Gjithashtu në ankim, subjekti është shprehur që pamundësia e paraqitjes së provave/akteve, për të cilat ka rezervuar të drejtën e paraqitjes në vijim (që në referim të ankimit duket se ka të bëjë me provat për të ardhurat e kunatit të tij me qëndrim në Itali), lidhet me situatën e krijuar nga pandemia e COVID-19. Trupi gjykues vëren se nga aktet në fashikull rezulton se Komisioni i ka dhënë subjektit kohë të mjaftueshme për paraqitjen e mbrojtjes dhe provave. *Së dyti*, hetimi administrativ ka zgjatur nga tetori 2019 deri në janar 2021, për rreth 15 muaj, ndërsa kufizimet e lëvizjes për shkak të pandemisë përbejnë vetëm një periudhë nga marsi deri në qershor 2020. Gjatë kësaj periudhë, subjekti ka kërkuar dhe i është dhënë tre herë kohë shtesë për t'iu përgjigjur pyetësorëve. Subjekti nuk rezulton të ketë ngritur pretendime kundrejt zgjatjes së këtyre afateve më tej. Vetëm një prej shtyrjeve është argumentuar prej subjektit për shkak të mosaksesimit të *e-mail-it* zyrtar, gjatë kohës së kufizimit të lëvizjeve.

9.10. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se pretendimi i subjektit, për pamundësi të paraqitjes së provave *për shkak të pandemisë COVID-19*, nuk rezulton i bazuar në rrjedhën e hetimit administrativ që rezulton nga aktet, sikurse edhe paraqitet si një shkak i ri në ankim, i pangritur e argumentuar më parë. Më e rëndësishmja, subjekti nuk solli prova të reja në këtë drejtim as në vijim në Kolegj, ndonëse ka sjellë parashtrime të tjera dhe seanca për shqyrtimin e ankimit të tij u zhvillua në nëntor 2023, teorikisht pasi ka kaluar kohë e mjaftueshme për të administruar aktet, nëse arsyeja e mosparaqitjes së tyre ishte pasojë e masave të jashtëzakonshme për shkak të pandemisë në mars – qershor 2020 apo largësia gjeografike e vendqëndrimit të kunatit të tij. *Së fundmi*, në kushtet që subjektet e rivlerësimit ishin të ndërjegjeshëm për faktin që Aneksi i Kushtetutës, ligji nr. 84/2016 dhe Udhëzimi nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, i ILDKPKI-së, parashikojnë qartë barrën e provës për të dokumentuar pretendimet, që në vitin 2016 periudha tremujore e kufizimeve të pandemisë nuk mund të argumentohet si shkak për të evituar përmbushjen e detyrimeve në funksion të procesit të rivlerësimit. Ndaj, përpos faktit që subjektit i është lënë afat i mjaftueshëm nga Komisioni, shkak që paraqitet si pengesë për sigurimin e dokumentacionit u vlerësua nga trupi gjykues i Kolegjit i pabazuar dhe i paprovuar, sipas kritereve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, edhe nga një analizë e thjeshtë e datave që mbajnë kërkesat për informacion të dërguara nga subjekti.

---

*t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj*".

<sup>12</sup> Subjekti e ka paraqitur këtë akt edhe në përgjigjet e pyetësorit nr. 5, pranë Komisionit.



9.11. Në përmbledhje dhe si konkluzion i sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se provat e reja të paraqitura në ankim nuk përmbushin kriteret e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 dhe nuk u pranuan, nën dritën e dispozitave të nenit 49, pika 6, shkronjat “a”, “b” dhe “d” e ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur rrethana që kanë penguar paraqitjen e tyre në Komision, nuk përbëjnë fakte të reja të panjohura më parë, apo të cilat mund të kenë ndikim në vendimmarrjen e Kolegjit.

*d) Në lidhje me kërkesën për riçelje të pjesshme të hetimit dhe kalimin në seancë publike*

9.12. Trupi gjykues vlerëson se kërkesa e subjektit për riçelje të pjesshme të hetimit, sipas pikës 1, të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, është e pabazuar. Komisioni ka kryer hetimin për subjektin e rivlerësimit për të tria kriteret e rivlerësimit. Për kriterin e pasurisë, Komisioni ka konkluduar se subjekti ka bërë deklaratime të pasakta e të pamjaftueshme, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 e, për pasojë, zbatohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra. Për dy kriteret e tjera, subjekti ka rezultuar i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës. Subjekti është njohur me analizën financiare dhe vlerësimin e detajuar të shpenzimeve në formë tabelare, si dhe çdo referencë/provë e përdorur nga Komisioni. Kërkesa për riçelje të hetimit për përsëritjen e analizës financiare nën dritën e nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 është e pabazuar. Trupi gjykues vëren se gjendja faktike është konstatuar në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe nuk paraqitet nevoja për të vërtetuar fakte dhe marrë prova të reja në kushtet që aktet e sjella nga subjekti, sikurse referuar gjerësisht më sipër, nuk përmbushin testin e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012. Po ashtu, trupi gjykues nuk konstatoi shkelje të rënda procedurale në vendimin objekt ankimi.

9.13. Në përmbledhje të sa më sipër, Kolegji çmon se aktet e reja të sjella nga subjekti me ankimin duhet të refuzohen në zbatim të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk lejohen nga ligji – arsyetuar më sipër nën dritën e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 – si dhe për shkak se janë të panevojshme për vendimmarrjen dhe lidhen me fakte që edhe nëse pranohen të mirëqena janë parëndësi në zgjidhjen e çështjes dhe nuk kanë fuqinë të ndryshojnë rezultatin përfundimtar, parashikuar nga germet “b” dhe “d”, pika 6, e nenit 49 e ligjit nr. 84/2016. Për këto arsye, pasi Kolegji shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike, analizoi aktet bashkëlidhur ankimit dhe vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë hetimit në Komision, vendosi të shqyrtojë ankimin mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi, sipas nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

*B. Vlerësimi i Kolegjit për pretendimet e lidhura me cenimin e procesin e rregullt ligjor*

*(i) Përbërja e trupës gjyqësore të Komisionit*

10. Subjekti pretendon se është cenuar neni 6 i KEDNj-së, pasi në përbërjen e Komisionit nuk ka pasur përfaqësim të gjyqtarëve, sipas vlerësimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GjEDNj”), në çështjen *Volkov* kundër Ukrainës, ku ka theksuar që procedurat disiplinore në ngarkim të gjyqtarëve duhet të kryhen nga organe në të cilat “të paktën gjysma e anëtarëve” janë gjyqtarë. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky pretendim i subjektit është i pabazuar. Sikurse shtjelluar gjerësisht në çështjen kyç të jurisprudencës së GjEDNj-së, në lidhje me procesin e rivlerësimit kalimtar, *Xhoxhaj* kundër Shqipërisë<sup>13</sup>, organet e rivlerësimit dhe mënyra e veprimit

<sup>13</sup> 299 [...] Sidoqoftë, Gjykata duhet të marrë parasysh natyrën e posaçme të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri. Ky proces mori jetë në përgjigje të nevojës urgjente, siç vlerësohet nga legjislatura vendëse,

të tyre, sikurse edhe anëtarësia e komisionerëve jo nga radhët e drejtësisë, janë vlerësuar në përputhje me Konventë dhe jurisprudencën e saj [GjEDNj]. GjEDNj-ja ka theksuar më tej rëndësinë e garancive të parashikuara në legjislacionin e brendshëm, konkretisht, faktin që Komisioni ka diskrecion të plotë në marrjen e vendimeve për strukturën e saj organizative dhe personelin dhe nuk merr udhëzime ose orientime nga ekzekutivi. Në të njëjtën linjë ka vlerësuar më herët edhe Komisioni i Venecias apo Gjykata Kushtetuese dhe gjetur zbatim në praktikën e Kolegjit<sup>14</sup>. Për sa më lart, Kolegji e gjen të papranueshëm pretendimin e subjektit që lidhet me qenien gjyqtar të anëtarëve të Komisionit. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson të mos ndalet më tej duke e refuzuar *en plano* këtë pretendim të subjektit.

(ii) *Plotësimi i kriterëve të zgjedhshmërisë nga anëtarët e Komisionit*

11. Subjekti pretendon se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, pasi i është mohuar e drejta për t'u dëgjuar dhe mbrojtur në mënyrë efektive nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, duke shkelur parimin e barazisë së palëve dhe të kontradiktorialitetit, sipas nenit 6 të KEDNj-së dhe nenit 42 të Kushtetutës. Sipas tij, trupi gjykues i Komisionit nuk plotëson kriteret formale për t'u zgjedhur si anëtarë Komisioni, konkretisht atë të vjetërsisë në punë, pasi, sipas tij, asnjëra nga komisionerët nuk ka punuar 15 vjet në nivel drejtues apo ka përvojë në fushën e së drejtës administrative ose sfera të tjera të së drejtës.

11.1. *Së pari*, trupi gjykues i Kolegjit i gjen të pabazuara pretendimet e subjektit për shkelje të nenit 42 të Kushtetutës e garancive të tjera për proces të rregullt, referuar në mbështetje të këtij shkakut ankimi. Nga aktet në fashikull rezulton që subjekti ka pasur korrespondencë të vazhdueshme me Komisionin, ka kërkuar dhe i është dhënë kohë shtesë në çdo rast për të gjitha arsyet e parashtruara dhe i është dhënë mundësi të japë shpjegime e paraqesë akte në mbështetje të tyre. Konkretisht, në datën 14.10.2019, subjekti është njoftuar nëpërmjet *e-mail*-it për nisjen e procesit, përbërjen e trupit gjykues dhe ka marrë pyetësorin nr. 1 dhe afatin [15-ditor] për përgjigjet. Në datën 27.10.2019, subjekti ka konfirmuar marrjen dijeni për sa më sipër, ka shprehur dakordësinë me trupin gjykues dhe mungesën e konfliktit të interesit. Nga aktet nuk rezulton asnjë pretendim i ngritur gjatë gjithë procesit, për mosdhënie kohë apo mundësie për të parashtruar argumente apo sjellë akte, sikurse që as Komisioni të mos ketë pranuar kërkitime procedurale të subjektit.

11.2. Po ashtu, nuk rezulton që subjekti të ketë ngritur pretendime për mosrespektim të parimit të barazisë së armëve, mosnjohje të fashikullit apo mosadministrim të provave të sjella prej tij. Ky konstatim është në linjë edhe me faktin që hetimi administrativ për subjektin ka zgjatur për përreth 15 muaj, që nënkupton në parim kohë të konsiderueshme e të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen dhe parashtruar argumente. Subjekti është paraqitur fizikisht në Komision në datën

---

*për të luftuar nivelin e lartë të korrupsionit që kish pushtuar sistemin e drejtësisë. Ky proces përbëhet nga rivlerësimi i tri kriterëve dhe ka për qëllim rivlerësimin të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë. Dhe është pikërisht kjo arsyeja që procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri është sui generis dhe duhet të dallohet nga çdo proces i zakonshëm disiplinor ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve [...].*

300. Sipas këndvështrimit të gjykatës, fakti që anëtarët e KPK-së nuk vinin nga radhët e gjyqtarëve profesionistë në detyrë, ishte në përputhje me frymën dhe qëllimin e procesit të rivlerësimit, domethënë për të shmangur çdo konflikt individual interesi dhe për të siguruar besimin e publikut në këtë proces.

<sup>14</sup> Shih, ndër të tjerë, vendimet e Kolegjit që i përkasin subjekteve të rivlerësimit Hajrie Muçmata dhe Tritan Hamitaj.

01.12.2020, është njohur me dosjen dhe ka marrë një kopje elektronike<sup>15</sup> të saj. Në datën 11.12.2020, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur raport të paaftësisë së përkohshme në punë për periudhën nga 09.12.2020 - 23.12.2020. Bazuar në këtë raport mjekësor, Komisioni i dha subjektit kohë shtesë<sup>16</sup> deri më 28.12.2020, për të sjellë shpjegimet e tij në përgjigje të barrës së provës. Subjekti i rivlerësimit, përmes postës elektronike<sup>17</sup>, ka paraqitur shpjegimet mbi rezultatet e hetimit kryesisht, bashkë me prova të reja në mbështetje të barrës së provës. Në asnjë nga këto ndërveprime nuk është referuar prej tij problematikë në funksion të ushtrimit të të drejtave të procesit të rregullt. E njëjta situatë rezulton nga vijimi i procesit në Komision.

11.3. Më tej, nuk rezulton që subjekti të ketë kontestuar përbërjen e trupës gjyquese, në asnjë fazë të procesit në Komision, përfshirë edhe seancën dëgjimore. Nga ana tjetër, shkresa e Avokatit të Popullit, mbi të cilën subjekti mbështet gjithë pretendimet e tij për kriteret e munguara të zgjedhshmërisë nga tre komisioneret, mban datën 03.03.2017. Me fjalë të tjera, subjekti duhet të kishte dijeni për ekzistencën e kësaj shkrese në momentin kur ka konfirmuar mospasjen e konfliktit të interesit apo të ndonjë rezerve që lidhej me zhvillimin e procesit të rregullt për shkak të anëtarësisë së trupit gjykues. Për këto arsye, argumentet e ngritura në ankim mbi bazën e një akti shkresor të disa viteve më parë, për të provuar mosplotësimin e kushteve të zgjedhshmërisë nga komisioneret e shortuara në trupin gjykues që kreu rivlerësimin e tij në Komision, e bëjnë pretendimin e subjektit të pakuptimtë dhe të pabazuar. Së fundmi, subjekti nuk ka ilustruar asnjë situatë konkrete faktike gjatë procesit së zhvilluar në Komision, që të ketë krijuar përshtypjen e cenimit të paanësisë qoftë edhe në planin subjektiv. Edhe nga analiza e akteve në fashikuj, trupi gjykues i Kolegjit nuk konstatoi ndonjë rrethanë apo indicie që mund të vlerësohej në këtë drejtim.

11.4. *Së dyti*, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se është i pabazuar edhe pretendimi se është cenuar parimi i gjykimit nga një *gjykatë e krijuar me ligj*, për shkak se komisioneret nuk përmbushnin kriteret e zgjedhshmërisë. Nën dritën e jurisprudencës së GjEDNj-së në çështjen *Astraðsson* kundër Islandës apo edhe *Cani* kundër Shqipërisë, duke abstraguuar nga fakti që subjekti e ngre për herë të parë këtë kërkim në ankim, trupi gjykues rithekson arsyetimin e shtjelluar në vendime të mëparshme për këtë aspekt<sup>18</sup>, ku është konkluduar se përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit iu nënshtrua disa procedurave të mirëpërcaktuara në Kushtetutë [neni C i Aneksit të saj dhe në nenin 6 të ligjit nr. 84/2016], të konfirmuara edhe nga GjEDNj-ja në çështjen *Xhoxhaj* kundër Shqipërisë.

11.5. Nga ana tjetër, pretendimet e subjektit në ankim nuk kanë asnjë ngjashmëri edhe në nivelin teorik me rrethanat e konstatuar nga GjEDNj-ja në çështjen *Cani* kundër Shqipërisë. Në rastin konkret, ndryshe nga konteksti i çështjes *Cani*, mospërmbushja e kriterit të vjetërsisë në punë përbën një pretendim të paprovuar e vlerësuar të një pale – subjektit të rivlerësimit. Ligji parashikon në mënyrë specifike si mund të ndryshonte lista e hartuar nga Avokati i Popullit. Ky fakt i vetëm konfirmon që lista e përpiluar nga ai institucion nuk përbënte dokument përfundimtar. Miratimi i listës i është nënshtruar kontrollit të komisionit *ad-hoc* në Kuvend, e më pak është

---

<sup>15</sup> Rezulton se në vendimin përfundimtar ka një lapsus, pasi thuhet se subjekti i rivlerësimit nuk është paraqitur për t'u njohur me dosjen e hetimit -- Paragrafi 7, faqe 3 e vendimit ndërkohë që aktet në fashikull konfirmojnë të kundërtën.

<sup>16</sup> Nëpërmjet e-mail-it të orës 8:41, subjekti ka përcjellë raport për paaftësi në punë. Në të njëjtën ditë, në orën 13:41, Komisioni ka njoftuar subjektin për afatin e shtyrjes së përgjigjeve të rezultateve të hetimit.

<sup>17</sup> E-mail i Komisionit, datë 28.12.2020, me relacionin përfundimtar dhe përgjigjet për subjektin e rivlerësimit.

<sup>18</sup> Shih, ndër të tjerë, vendimet e Kolegjit (JR) nr. 43/2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Hajrie Muçmata dhe (JR) nr. 3/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Tritan Hamitaj,

miratuar në bllok, duke reflektuar kështu vullnetin politik të Kuvendit. Këto dispozita të ligjit tashmë kanë kaluar testin e “gjykatës së pavarur të krijuar me ligj” nga Komisioni i Venecias sikurse edhe GjEDNj-ja. *Së fundmi*, sikurse edhe në vendime të mëparshme, trupi gjykues i Kolegjit çmon të rikonfirmojë që pretendimi i subjektit nuk përkon as edhe me testin e balancës mes të drejtave dhe ushtrimit të tyre në kohë, elaboruar nga GjEDNj-ja në çështjen *Adstraðsson kundër Islandës*, sipas së cilës: “[...] *Me kalimin e kohës, ruajtja e sigurisë juridike ka një peshë gjithnjë e më të madhe në lidhje me të drejtën e palës ndërgjyqëse individuale për një “tribunal të krijuar me ligj” në ushtrimin balancues që duhet të kryhet [...]”*<sup>19</sup>.

(iii) *Vlerësimi i trupit gjykues për pretendimin për cenim të parimit të kontradiktorialitetit, mbrojtjes efektive dhe barazisë së armëve*

12. Subjekti pretendon se Komisioni ka vepruar “me doza të larta paragjykimi”, në kushtet që nuk i ka vënë në dispozicion provat mbi të cilat ka mbështetur vendimmarrjen. Ky pretendim ka për fokus një denoncim të mbërritur në Komision gjatë hetimit administrativ. Subjekti argumenton që denoncuesi është anonim e, për pasojë, hetimi i kryer mbi bazën e indicieve që referohen në të përbën cenim të parimit të kontradiktorialitetit dhe barazisë së armëve. Në denoncimin<sup>20</sup> në fjalë, i cili *nuk* është anonim, sikurse shpjegohet në vijim, pretendohet që subjekti ka ndërtuar dy kate pa leje, të cilat janë në emër të babait dhe ka përfutur nëpërmjet kolegëve pandëshkueshmëri për këto veprime. Po ashtu, denoncuesi pretendon se subjekti ka pasuri, të cilat nuk justifikohen me të ardhura të ligjshme, të fshehura në emër të familjarëve. Ndër to përfshihen disa apartamente në Berat, ai në Tiranë, blerë në emër të vjehrrës së tij, si dhe të tjera pasuri e automjete.

12.1. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe ky pretendim i subjektit është i pabazuar. Ky konstatim mban në konsideratë, jo vetëm faktin që identiteti i denoncuesit është i njohur për Komisionin, por mbi të gjitha sepse gjatë procesit Komisioni i ka dhënë mundësi subjektit të njihet me faktet e aluduara dhe të japë shpjegime për hetimet e pavarura të kryera në këtë drejtim. Nga analiza e shkëmbimeve shkresore midis subjektit të rivlerësimit dhe Komisionit, si dhe nga verifikimi i procesverbalit të seancës dëgjimore, nuk rezulton që subjekti të ketë paraqitur pretendime për shkelje të të drejtave të garantuara në ligj për procesin e rregullt ligjor gjatë rivlerësimit në Komision.

12.2. Nga aktet në fashikull rezulton se më 04.07.2019, Komisioni ka marrë një denoncim nga një individ, i cili *ka kërkuar* që të mbetet anonim për subjektin e rivlerësimit. Komisioni ka ruajtur identitetin e denoncuesit në përputhje me vullnetin e tij, sikurse parashikon neni 53 i ligjit nr. 84/2016<sup>21</sup>. Në vijim, Komisioni ka kryer hetim të tij kryesisht, nga i cili ka rezultuar se babai i subjektit ka ndërtuar një shtesë kati, në shtëpinë në Berat, pa leje ndërtimi. Ky fakt është referuar nga policia dhe Prokuroria ka regjistruar një procedim penal [më datë 03.11.2014], për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal<sup>22</sup>. Komisioni i ka analizuar edhe pretendimet e tjera në denoncim, në kuadër të kriterit të pasurisë (*konkretisht, shtëpinë e vjehrrës në përdorim*). Denoncimi është bërë pjesë e dosjes hetimore të Komisionit dhe

<sup>19</sup> *Adstraðsson kundër Islandës* <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-206582> parag. 252.

<sup>20</sup> Dërguar nëpërmjet e-mail-it në Komision, nr. {\*\*\*} prot., datë 04.07.2019.

<sup>21</sup> “[5.] Të drejtat dhe interesat e personave që denoncojnë mbrohen automatikisht në mënyrë të besueshme, të efektshme dhe të përshtatshme, sipas standardeve të parashikuara në ligjin “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

<sup>22</sup> *Kjo veprë është shuar për shkak të amnistisë, sipas ligjit nr. 22, datë 10.03.2014.*

rezultateve të hetimit dhe subjekti është njohur dhe i ka kaluar barra e provës për informacionin që përcillet në të.

12.3. Për rrjedhojë, nga sa më sipër rezulton se procesi i kryer nga Komisioni ka qenë në përputhje me garantitë e procesit të rregullt, përfshirë edhe të drejtën e procesit kontradiktor. Po ashtu, nga aktet në fashikull nuk rezulton që hetimi të ketë qenë diskriminues, edhe duke abstraguuar nga fakti që hetimi për denoncimet nga institucionet e rivlerësimit është diskrecion i parashikuar shprehimisht nga ligji. Bashkë me vendimin për përfundimin e hetimit administrativ, kalimin e barrës së provës mbi rezultatet e hetimit dhe të drejtën për t'u njohur me provat e administruara, në datën 17.11.2020, përmes postës elektronike<sup>23</sup>, Komisioni i ka bërë me dije subjektit edhe faktet që rezultuan nga denoncimi dhe ka dhënë 13 ditë kohë për shpjegimet që ai shihte të arsyeshme, për të kërkuar administrimin e provave të reja apo thirrjen e dëshmitarëve, në funksion të të provuarit të të kundërtës së barrës së provës.

12.4. Po ashtu, përkundër çfarë pretendon subjekti, nga aktet rezulton që subjekti është njohur me dokumentacionin e dosjes së hetimit administrativ të zhvilluar në Komision, përfshirë provat e administruara në procesin e hetimit, sikurse edhe me aspektet që lidheshin me hetimin kryesisht të kryer nga Komisioni mbi bazën e denoncimit objekt i kësaj analize. Sipas deklaratës së nënshkruar nga subjekti, që mban datën 01.12.2020, ai mori të gjithë dokumentacionin e kërkuar në CD dhe/apo në formë shkresore (fotokopje). Subjekti po ashtu ka deklaruar që nuk ka asnjë vërejtje për sa i përket dokumentacionit/materialit të tërhequr në Komision dhe se dokumentacioni përputhej me dosjet që iu vunë në dispozicion dhe inventarin përkatës. Bashkëlidhur deklaratës së nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, gjendet një fotokopje e dokumentit të identifikimit të tij personal<sup>24</sup>. Për më tepër, përgjatë harkut kohor të një viti, në të cilin është zhvilluar hetimi, Komisioni ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me subjektin, duke e njohur me provat, duke i kërkuar sqarime dhe duke marrë në konsideratë aktet dhe shpjegimet e subjektit.

12.5. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti e konsideroi denoncimin si të *pavërtetë* dhe që ishte bërë me qëllim *denigrimin e figurës së tij*. Blerja e apartamentit në Tiranë, sipas subjektit, ishte *një trillim* dhe në tërësi denoncimi ishte *i sajuar*. Përveç këtyre shpjegimeve, subjekti dha sqarime dhe dërgoi në Komision dokumentacion për të përmbushur barrën e provës, përfshirë edhe lidhur me çfarë pretendohet në denoncim për shtëpinë e vjehrrës, në Tiranë, që përdorej prej tij [subjektit]. Për më tepër, në observacionet e dërguara nga përfaqësuesja ligjore e subjektit të rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, janë kundërshtuar gjetjet e Komisionit në mënyrë individuale dhe të hollësishme<sup>25</sup>. Subjekti ka marrë pjesë në seancën dëgjimore edhe nëpërmjet përfaqësueses ligjore dhe ka parashtruar qëndrimin e tij mbi gjetjet e Komisionit, sikurse edhe ka diskutuar me anëtarët e trupit gjykues dhe me vëzhguesin ndërkombëtar gjatë seancës dëgjimore.

12.6. Së fundmi, sikurse pasqyruar edhe më sipër, Komisioni i ka lënë subjektit afat 13-ditor, nga data 17 -- 30.11.2020, për të ushtruar të drejtat e tij në funksion të barrës së provës dhe i ka dhënë kohë shtesë dy herë. Subjektit i është dhënë më tepër se një muaj kohë shtesë, deri më 28.12.2020. Komisioni ka ftuar subjektin e rivlerësimit të marrë pjesë në seancën dëgjimore të caktuar në datën

<sup>23</sup> E-mail i Komisionit, datë 17.11.2020, ora 2:30, "Komisioni – njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht për procesin e rivlerësimit".

<sup>24</sup> "Leje drejtimi" dhe dokumenti i identifikimit nga Prokuroria Tiranë.

<sup>25</sup> Titulli i këtyre shpjegimeve është "Observacion i Prokurorit Arben Allajbeu për të vërtetuar të kundërtën dhe në përgjigje të barrës së provës".

12.01.2021, gjatë të cilës ai është përfaqësuar nga avokatja e autorizuar për këtë qëllim. Përfaqësuesja e subjektit ka debatuar rreth provave, iu është përgjigjur pyetjeve, dhe ka realizuar mbrojtjen e subjektit të rivlerësimit, sipas diskrecionit të saj dhe tagrave të deleguara në prokurë. Përfaqësuesja ligjore, në asnjë moment, nuk ka ngritur pretendime në lidhje me ndonjë pengesë të shfaqur gjatë procesit në Komision. Në përmbledhje të gjithë këtyre konstatimeve, rezulton se subjektit i janë vënë në dispozicion provat dhe faktet që kanë rezultuar nga hetimi, duke respektuar në tërësi të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në mënyrë efektive, pa kufizim. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se i është mohuar e drejta për një mbrojtje efektive është i pabazuar dhe i pakuptimtë.

12.7. Ndryshe nga sa pretendon subjekti, vlerësimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë është rezultat i interpretimit të dispozitave ligjore përkatëse në rrethanat e faktit dhe jo pasojë e moskonsiderimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura prej subjektit. Kuadri ligjor, në të cilin Komisioni është mbështetur për interpretimin e fakteve dhe konkluzionet e vlerësimit, është cituar shprehimisht në tekstin e vendimit për secilin konkluzion, përkatësisht në paragrafët 1.29, 2.34, 3.29, 4.13, 5.56, 6.50, 9.11, 9.24 dhe 10.11, ndër të tjerë. Ky fakt e bën të pabazuar pretendimin se Komisioni nuk ka respektuar parimin e ligjshmërisë. Vendimi për shkarkimin nga detyra është marrë në raport me rezultatin përfundimtar të procesit, lidhur me deklaramin e pamjaftueshëm në kriterin e pasurisë dhe mungesës së burimeve financiare për të justifikuar pasurinë, duke qenë kështu brenda rekuizitave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe në përputhje me nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

12.8. Në përmbledhje të sa më sipër, në kushtet kur rezultoi e provuar se subjekti e ka ushtruar të drejtën për t'u njohur me dosjen, pretendimi i subjektit në ankim, për cenim të parimit të kontradiktorialitetit dhe barazisë së armëve, nuk gjen mbështetje në situatën faktike. Po ashtu, Komisioni ia ka garantuar subjektit të drejtën për proces të rregullt ligjor, në mbështetje të nenit 46 të Kushtetutës, duke ia nënshtuar provat debatit në seancën dëgjimore. Si të tilla, këto pretendime u vlerësuan të pabazuara nga trupi gjykues i Kolegjit.

13. Subjekti ka potencuar, po ashtu, se analiza financiar e kryer në Komision është e gabuar. Duke theksuar njohuritë e posaçme që kërkon kryerja e analizës financiare, subjekti kërkon të njihet me *identitetin* e personit që e ka hartuar atë, si dhe përgjegjësinë ligjore të këtij/këtyre anëtarëve të stafit, si dhe njohuritë që ata kanë. Subjekti pretendon edhe që Komisioni *nuk* e ka njohur me analizën financiare që kreu pas paraqitjes së provave. Pasi analizoi këto pretendime, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim dhe akteve në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit i gjeti këto kërkime të pabazuara, sikurse shtjellohet në vijim.

13.1. Analiza financiare në Komision, ashtu sikurse edhe në Kolegj, kryhet nga Njësia e Shërbimit Ligjor, që funksionon pranë institucioneve të rivlerësimit. Njësia e Shërbimit Ligjor është strukturë që funksionon bazuar në parashikimet e neneve 22 dhe 23 të ligjit nr. 84/2016. Ajo përbëhet nga ekspertë me njohuri të thelluara ekonomike dhe juridike, të cilët studiojnë dosjen nga pikëpamja financiare dhe ligjore<sup>26</sup>. Edhe përgjegjësia ligjore dhe roli i tyre është përcaktuar në dispozitat e sipërcituara të ligjit. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit për mosnjohje të përgjegjësive ligjore, në bazën e të cilave funksionojnë këshilltarët ekonomikë të Komisionit, është i pakuptimtë në kushtet që ato përcaktohen nga ligji. Po ashtu, duke mbajtur në konsideratë që këshilltarët veprojnë

<sup>26</sup> Shih vendimin e Kolegjit (JR) nr. 3/2021, që i përket subjektit të rivlerësimit Albina Spaha.

nën orientimin e relatorit/relatores, identiteti i të cilit/ës njihet nga subjekti gjatë gjithë procesit apo që vendimmarrja është kryekëput tagër e anëtarëve të trupit gjykues, identiteti i të cilëve është i njohur nga subjekti, ky pretendim i subjektit është i pakuptimtë.

13.2. Për nga përmbajtja, dhe në vijim të aspektit tjetër të parashtruar nga subjekti për analizën financiare, nga aktet në fashikuj – sikurse referuar edhe më sipër në detaj për njohjen e dokumentacionit nga subjekti dhe dërgimin e prapësimeve të tij për rezultatet e hetimit – subjekti, jo vetëm që është njohur me gjithë dokumentacionin në fashikull në përgjithësi, por është njohur edhe me metodologjinë e përdorur nga Komisioni në funksion të hartimit të *analizës financiare*, si dhe me tabelën e detajuar të shpenzimeve nëpërmjet rezultateve të hetimit. Këto fakte rezultojnë qartë nga shtojcat që pasqyrojnë analizën financiare të detajuar dhe metodologjinë, bashkëngjitur rezultateve të hetimit, si dhe referimin e tyre nga përfaqësuesja e tij ligjore në prapësimet për rezultatet e hetimit<sup>27</sup>. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit është i pakuptimtë dhe i pabazuar.

13.3. Në përfundim, subjektit i është garantuar -- dhe ai e ka shfrytëzuar -- e drejta për t'u shprehur për provat e dorëzuara në seancën dëgjimore. Për të gjithë provat e tjera, subjekti ka pasur mundësinë e të provuarit të të kundërtës së rezultateve të hetimit. Nga ana tjetër, nëse për çdo analizë që kryen Komisioni do të ndërvepronte me subjektet, procesi i rivlerësimit do të ishte i pamundur të konkludohej, përpos që do të ishte i tejzgjatur. Analiza financiare e pasqyruar në vendimin përfundimtar të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit, i nënshtrohet kontrollit -- që sipas Kushtetutës e ligjit kryhet nga Kolegji -- dhe është objekt analize i *këtij* vendimi në vijim. Në këto kushte, pretendimet e subjektit, që lidhen me analizën financiare të përcjellë në vendimin e Komisionit apo me mosnjohjen me të, nuk qëndrojnë.

14. Subjekti pretendon cenim të të drejtave nga neni 8 i KEDNj-së, pasi masa e dhënë nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe pasuria e tij nuk tejkalon dyfishin e parashikuar nga ligji. Për pasojë, kjo masë qartësisht përbën ndërhyrje në jetën private dhe familjare të tij dhe ai nuk mund të ushtrojë *asnjë profesion tjetër*, shprehet subjekti. Nga analiza e kryer nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, jurisprudencës tashmë të zhvilluar edhe nga GjEDNj-ja në kontroll të përputhjes së kuadrit ligjor për rivlerësimin me garancitë e KEDNj-së për proces të rregullt, trupi gjykues i Kolegjit i gjen të pabazuara edhe këto pretendime. Arsyetimi shtjellohet në vijim.

14.1. Sikurse elaboruar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit, por tashmë konfirmuar edhe nga kontrolli i kryer nga GjEDNj-ja nëpërmjet çështjes kyç të rivlerësimit, *Xhoxhaj* kundër Shqipërisë, masa disiplinore e shkarkimit parashikuar nga ligji shqiptar nuk është disproporcionale dhe as në shkelje të parimeve të nenit 8 të Konventës<sup>28</sup>. Ndonëse është e vërtetë që subjekti nuk gjendet në kushtet e deklaramentit të dyfishit të pasurisë së ligjshme, një ndër situatat ligjore të parashikuara nga neni 61<sup>29</sup> i ligjit nr. 84/2016, masa disiplinore e shkarkimit për të është marrë bazuar në një pikë tjetër të së njëjtës dispozitë. Konkretisht, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka kryer deklarament të

---

<sup>27</sup> Ndër të tjerë, referuar në faqen 16, paragrafi 33 të “*Observacioneve në përgjigje të barrës së provës*”, depozituar nga përfaqësuesja ligjore e subjektit, znj. Sevdari dhe Aneksi 1 dhe 2, i Rezultateve të Hetimit, dërguar subjektit nga Komisioni në datën 17.11.2020.

<sup>28</sup> Shih paragrafin 402 dhe 403 të vendimit të GjEDNj-së në çështjen *Xhoxhaj* kundër Shqipërisë.

<sup>29</sup> Shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore në këto raste: 1. Kur rezultojnë se ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të.

pasaktë, ka mungesë burimesh dhe ka fshehur pasurinë<sup>30</sup>, kushte që përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

14.2. Secila prej situatave ligjore që përfshihet nën ombrellën e nenit 61, është autonome prej të tjerave dhe nuk përbën parakusht për të tjerat, sikurse rezulton edhe nga gjuha e dispozitës, e cila nuk lë vend për argumentim që ato duhet të vërtetohen në mënyrë kumulative. Me fjalë të tjera, institucionet e rivlerësimit mund të marrin masën disiplinore të shkarkimit nëse vërtetohet të paktën njëra prej tyre. Veçoria e situatës së dyfishit të pasurisë, parashikuar në pikën 1 të nenit 61, është që nëse ajo konstatohet organet e rivlerësimit nuk kanë diskrecion e masa e shkarkimit është rrjedhojë e pakontestueshme<sup>31</sup>. Në rrethanat konkrete, në të gjithë aspektin pasuror të kontrolluar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me *mungesë burimesh* financiare të ligjshme për krijimin e pasurive, sikurse edhe me *fshehje* pasurie. Në këto kushte, masa disiplinore e subjektit ka qenë rrjedhojë logjike e vlerësimit të kriterit të pasurisë në hetimin administrativ të kryer nga Komisioni. Për këto arsye, pretendimi për cenim të dispozitës së nenit 61 apo të parimit të proporcionalitetit është i pabazuar.

14.3. Nga ana tjetër, procesi i rivlerësimit nuk passjell ndalimin e ushtrimit të profesionit në çdo kapacitet për magjistratët që nuk arrijnë ta kalojnë me sukses. Sikurse ka elaboruar edhe GjEDNj-ja në çështjen *Sevdari* kundër Shqipërisë (paragrafi 66<sup>32</sup>), është i pabazuar pretendimi për cenim të jetës private, *bazuar në frikë për të ardhmen për ushtrimin e profesionit*, pa pasur një akt konkret që e pengonte në ushtrimin e kësaj të drejte. Në këtë kontekst, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje edhe arsyetimin e GjEDNj-së në çështjen kyç *Xhoxhaj* kundër Shqipërisë, ku u vlerësua se shkarkimi nga detyra i subjekteve për shkak të shkeljeve nuk është inkonsistent apo disproporcional me qëllimin që kërkohet të arrihet nga shteti, pasi ka konsideruar se kontrolli i pasurive nuk përfshin një aspekt intim të sjelljes private. Në të njëjtën linjë ka arsyetuar gjerësisht edhe Kolegji në çështje të mëparshme lidhur me proporcionalitetin e masave që parashikon Kushtetuta dhe ligji, *vis a vis* të ardhmes profesionale të subjekteve të rivlerësimit që nuk kalojnë procesin me sukses (apo zgjedhin të mos i nënshtrohen procesit të rivlerësimit). Në këto raste, Kolegji ka mbajtur në konsideratë dhe ka përthithur vlerësimet e GjEDNj-së, për sa i përket diskrecionit të legjislatorit në vendosjen e ndalimeve të ushtrimit të funksioneve të caktuara publike, si proporcionale me qëllimin që synohet të arrihet, duke iu referuar, ndër të tjerë, edhe arsyetimit në *Niadin* kundër Rumanisë:

*“[...] Funkionarët publikë, sidomos ata që si kërkuesi kërkojnë të shërbejnë në pozicione si ai që kërkuesi ka dashur të kthehet, ushtrojnë një pjesë të sovranitetit të shtetit. Ndalimi i kërkuesit, për pasojë, nuk është disproporcional kundrejt objektivit legjitim të shtetit për të siguruar besnikërinë e atyre që mbajnë përgjegjësitë që shoqërohen me interesin e përgjithshëm. 55. Gjykata vëren se shteti nuk ka vendosur ndalime mbi punësimin e ardhshëm të kërkuesit në sektorin privat apo edhe në*

<sup>30</sup> Komisioni ka vlerësuar se subjekti: (i) [...] nuk ka deklaruar saktë pasuritë në përdorim dhe në pronësi; (ii) nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të përmendura në këtë vendim; dhe (iii) [...] ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi dhe në përdorim të tij dhe është përpjekur të fshehtë këto pasuri [...].

<sup>31</sup> Shih, ndër të tjerë, vendimin e Kolegjit (JR) nr. 32/2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Arjan Balliu – prg. 21.

<sup>32</sup> [...] Frika se ajo mund të bëhet viktimë e një shkeljeje të Konventës duke u përjashtuar në të ardhmen nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë nuk është e mjaftueshme që subjekti të pretendojë se rrezikon të prekej drejtpërdrejt nga neni 13(2) i Ligjit për Avokatët dhe se në këtë mënyrë ishte viktimë e shkeljes së të drejtave të saj të Konventës në këtë drejtim.



*kompani që paraqesin njëfarë interesi për shtetin në çështje ekonomike [...]. Po ashtu, kërkuesit nuk i ndalohet punësimi në një fushë tjetër të sektorit publik, që nuk passjell/përfshin ushtrimin e funksioneve publike [...].”<sup>33</sup>*

14.4. Në përmbledhje të sa më sipër, në kushtet që vendimi i marrë nga Komisioni bazohet në ligj dhe ky i fundit ka kaluar kontrollin e kushtetutshmërisë dhe atë të përputhshmërisë me garancitë e sanksionuara nga KEDNj-ja, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit, për cenim të të drejtës për jetë private dhe ushtrimin e profesionit, është i pabazuar. Në të njëjtën kohë, dhe po aq e rëndësishme, është të theksohet se nuk mund të argumentohet se vendimi i Komisionit shkel parimin e proporcionalitetit në kushtet që ka qenë rezultat i zbatimit të normës ligjore të parashikuar nga Aneksi i Kushtetutës e ligji nr. 84/2016.

15. Subjekti pretendoi edhe cenim të *procesit të rregullt ligjor*, meqenëse Komisioni ka kryer analizë [financiare] edhe për vitet 2017-2018. Sipas subjektit, *hetimi tej afatit të përcaktuar nga ligji* përbën mungesë arsytimi, tejkalim kompetencash dhe cenim të pavarësisë së gjyqësorit, për shkak se kontrolli tej këtij afati kryhet nga organet e tjera të drejtësisë. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni nuk e ka ngarkuar me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit për hetimin dhe konkluzionet e arritura për këtë periudhë kohore. Mbi këtë bazë, kjo zgjedhje e bërë nga Komisioni, duke mos gjetur pasqyrim në asnjë pasojë për subjektin, nuk ka pasur as efekt mbi masën disiplinore e, për rrjedhojë, nuk e bën as procesin e rivlerësimit të kryer të cenueshëm apo në kushtet e shkeljes së garancive të procesit të rregullt. Për këto arsye, ky pretendim i subjektit, për cenim pavarësie të gjyqësorit apo mungesë arsytimi, është i pabazuar. Arsyetimi i Kolegjit shtjellohet në vijim.

15.1. Nga aktet rezulton se Komisioni e ka arsyetuar kryerjen e analizës financiare për këto dy vite *për të krijuar një panoramë më të plotë dhe më të qartë të mundësive financiare të subjektit për të përballuar me burime të ligjshme financiare, kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve, ndër vite*<sup>34</sup>. Përpos konstatimit të balancave negative për secilin vit<sup>35</sup>, në pikën fundore, kjo analizë në vetvete nuk ka passjellë pasoja direkte në zgjidhjen e çështjes. Prej saj kanë rezultuar fakte të cilat i kanë shërbyer Komisionit për të qartësuar aspekte të tjera të periudhës së rivlerësimit, nën dritën e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, lidhur me pasuritë në përdorim të subjektit. Konkretisht, nëpërmjet këtij hetimi, Komisioni ka konstatuar porositjen në vitin 2018 të dy vendeve të parkimit nga vjehrra e subjektit, e cila nuk zotëron automjet apo leje drejtimi. Në vijim të këtyre të dhënave, Komisioni ka poseduar një indicie shtesë mbi të cilën ka konkluduar fshehje të pasurisë së subjektit në emër të vjehrrës së subjektit, dhe i ka gjetur të pabesueshme shpjegimet e tij.

15.1. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në rrethanat konkrete, jo vetëm që procesi i kryer nga Komisioni është i rregullt në tërësinë e tij -- sikurse analizuar gjerësisht më sipër -- por edhe kryerja e hetimeve për të plotësuar të dhënat që derivojnë nga deklaratat e pasurisë, nën dritën e detyrimit që përcakton Kushtetuta dhe ligji për hetimin që duhet të kryhet nëse organet e rivlerësimit kanë dyshime për fshehje pasurie, është në përputhje edhe me arsyetimin e Kolegjit për rastet përjashtimore e specifike kur Komisioni mund të analizojë veprime e deklarime të cilat

<sup>33</sup> Paragrafët 54-55, Naidin kundër Rumanisë, në lidhje me ndalimin e individëve që të kryejnë detyra të caktuara në institucionet të caktuara publike.

<sup>34</sup> Referuar paragrafit 10.10 të vendimit të Komisionit.

<sup>35</sup> Përkatësisht (-) 892.421 lekë për vitin 2017 dhe (-) 276.048 lekë për vitin 2018.

datojnë pas deklaratës *vetting*, për të konfirmuar saktësinë e vërtetësinë e kësaj të fundit<sup>36</sup>. Komisioni ka hetuar vetëm në funksion të dilijencës e objektivitetit që nevojitet si parakusht për të konstatuar një situatë serioze si ajo e aluduar në denoncim, për fshehje të pasurisë. Nga ana tjetër, në kushtet që masa e shkarkimit bazohet në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe vendimi i Komisionit është në përputhje me të gjithë elementët e anës formale, sipas nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, sikurse edhe është i qartë e nuk përmban thënie kontradiktore<sup>37</sup>, pretendimi i subjektit për cenim të procesit të rregullt është i pabazuar.

15.2. Në përmbledhje, për pretendimet e subjektit të rivlerësimit me natyrë procedurale, duke pasur parasysh edhe zbrëthimin e parimeve të procesit të rregullt ligjor referuar jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit, Gjykatës Kushtetuese dhe të GjEDNj-së, mbi gjykimin kontradiktor dhe barazinë e armëve, për rëndësinë e veçantë që merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve në proces, Kolegji konstaton se pretendimet e subjektit se Komisioni ka cenuar parimet e procesit të rregullt ligjor nuk qëndrojnë dhe rezultojnë të pambështetura në ligj dhe në aktet në fashikuj.

### C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e pasurisë

16. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi mori në shqyrtim shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në funksion të kontrollit të vendimit të Komisionit, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve të kryera, pasaktësisë së deklarimeve dhe fshehjes së pasurisë, parashikuar nga neni D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, sikurse përcaktuar edhe në gerrat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Në vijim, shtjellohet arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion, për secilin shkak ankimi.

17. *Apartament me sipërfaqe 64 m<sup>2</sup>, në Plazh, Durrës, me vlerë 15.000 euro*

17.1. Këtë pasuri, subjekti e ka deklaruar në deklaratën *vetting* të fituar me kontratë sipërmarrjeje të datës 12.09.2007, me burim krijimi një kredi nga Alpha Bank marrë më 17.10.2007. Komisioni ka konkluduar se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting*, sipas germës “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka deklaruar saktë burimin e krijimit të pasurisë -- një hua e marrë nga një individ. Po ashtu, sipas Komisionit, subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimin, sipas pikës 4, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj shume nga huadhënësi dhe është gjendur në kushtet e mungesës së burimeve për të krijuar pasurinë, sipas germës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

17.2. Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit dhe kërkon që si burim i krijimit të kësaj pasurie të konsiderohet kredia e akorduar nga Alpha Bank ShA., sipas kontratës së lidhur më datë 17.10.2007. Meqenëse apartamenti është blerë para miratimit të kredisë, subjekti pretendon në ankim se ka lidhur një kontratë huaje me huadhënësin [z. E. K.], të cilën e shleu në momentin e disbursimit të kredisë. Po ashtu, subjekti kërkoj që z. K., të mos merret në cilësinë e personit tjetër të lidhur, pavarësisht ekzistencës së huas së dokumentuar me deklaratë, pasi gjendet në kushtet e

<sup>36</sup> Shih, ndër të tjerë, vendimin e Kolegjit (JR) nr. 8/2021, që i përket subjektit të rivlerësimit Idriz Mulkurti, prg. 26.3 dhe vendimin (JR) nr. 22/2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Rilinda Selimi, prg. 16.10.

<sup>37</sup> Shih vendimet nr. 3, datë 19.02.2013 dhe nr. 55, datë 18.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese.

pamundësisë së sigurimit të dokumentacionit, pasi nuk legjitimohet të paraqesë kërkesa për dokumentacion që provojnë të ardhurat e një person të tretë.

17.3. Pasi vlerësoi aktet në fashikull, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka plotësuar saktë deklaratën e pasurisë *vetting*, lidhur me burimin e krijimit të pasurisë. Në kushtet që kredia është marrë pasi subjekti kishte kryer pagesën për apartamentin, ajo nuk mund të konsiderohet burim i krijimit të pasurisë. Nga ana tjetër, edhe në analizën e kryer në Kolegji, në funksion të shkaqeve të ankimit, huadhënësi ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme për të mbuluar financimin e apartamentit. Këto konkluzione arsyetohen në detaj në vijim.

17.4. Nga aktet rezulton se pasuria, në bashkëpronësi me bashkëshorten, është përfituar nëpërmjet kontratës së porosisë të datës 12.09.2007<sup>38</sup>. Sikurse referuar më sipër, subjekti ka deklaruar si burim krijimi kredinë nga Alpha Bank ShA., në shumën 15.000 euro, sipas kontratës së hartuar për këtë qëllim në datën 17.10.2007<sup>39</sup>. I njëjti burim i krijimit të pasurisë është deklaruar edhe në deklaratën para fillimit të detyrës, që mban datën 14.07.2014. Në përmbushje të barrës së provës, subjekti i paraqiti Komisionit: (i) kontratën noteriale të sipërmarrjes lidhur me shoqërinë ndërtuese [\*\*\*] ShPK; (ii) kontratën e huas me bankën [nr. {\*\*\*}, datë 17.10.2007]; (iii) shtesën e kontratës për kufi kredie shumëqëllimore [nr. {\*\*\*}, datë 17.10.2007]; si dhe (iv) deklaratën noteriale të huadhënësit që mban datën 05.10.2007. Deklarata noteriale e sipërcituar është konfirmuar nga huadhënësi edhe në datën 13.07.2020. Subjekti parashton se nëpërmjet kësaj huaje shleu vlerën e apartamentit në Durrës, sipas kontratës së porosisë.

17.5. Alpha Bank ka konfirmuar në datën 02.07.2020 se kredia në emër të subjektit [me limit 18.300 euro] u disbursua më datë 18.10.2007. Në kontratën e kredisë përcaktohet që subjekti ka paraqitur një projekt për blerje dhe rikonstruksion të apartamentit në Plazh-Durrës, me vlerë 20.000 euro. Nga kjo vlerë, 5.000 euro do të financohej nga kredimarrësi/subjekti dhe pjesa tjetër, 15.000 euro nga banka. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit përcolli kontratën e sipërmarrjes, datë 12.09.2007<sup>40</sup>, me shoqërinë ndërtuese sipas së cilës, sipërmarrësi/ndërtues do të dorëzonte apartamentin brenda datës 31.08.2008 dhe vlera prej 15.000 eurosh ishte likuiduar tërësisht nga porositësi. Nga aktet rezulton se në të njëjtën datë, subjekti i kaloi z. K. nëpërmjet llogarisë bankare vlerën 14.810 euro, duke e përshkruar “*kthim borxhi*”.

17.6. Nga sa më sipër, rezulton që kontrata e sipërmarrjes dhe pagesa datojnë rreth një muaj përpara miratimit dhe disbursimit të kredisë bankare. Në kontratë palët kanë pranuar dhe shprehur se çmimi është likuiduar tërësisht nga porositësi në datën e nënshkrimit më 12.09.2007. Edhe shlyerja e vlerës së apartamentit, është kryer përpara kredisë, dhe sipas subjektit, nëpërmjet huas së marrë. Në këto kushte, kredia nuk mund të argumentohet si burim krijimi i apartamentit, pasi edhe në rrethanat faktike të prezantuara nga subjekti ka pasur për qëllim shlyerjen e huas. Në momentin që është krijuar marrëdhënia juridike e porosisë, për finalizimin e saj shërbeu huaja. Në këtë kuptim, Kolegji vlerësoi se qëndrimi i Komisionit ka qenë i drejtë dhe i bazuar në ligj e në prova, dhe subjekti nuk ka deklaruar burimin e saktë të krijimit të pasurisë.

---

<sup>38</sup> Nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol.

<sup>39</sup> Kontrata e kredisë nr. {\*\*\*}.

<sup>40</sup> Nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., të datës 12.09.2007.

17.7. Është i pabazuar edhe pretendimi i subjektit për të mos konsideruar huadhënësin *person tjetër të lidhur*, meqenëse huaja u kthye brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Gjuha e nenit 32, pika 4<sup>41</sup> e ligjit nr. 84/2016, që përcakton rrethin e personave të tjerë të lidhur, nuk e kufizon këtë cilësi me kohën gjatë të cilës detyrimi mbetet i pashlyer. Në kushtet që burimi i krijimit nënkupton burimin në momentin e krijimit të pasurisë, sikurse është qartazi e shprehur në pikën 7 të Udhëzimit nr. 4095/2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, sikurse edhe në momentin e fitimit të pasurive<sup>42</sup>, nga leximi harmonik i këtyre dispozitave, rezulton që cilësia e personit tjetër të lidhur përcaktohet në momentin e fitimit të pasurisë dhe me ekzistencën e interesit pasuror, që në rastin konkret është marrëdhënia e *huas/borxhit*. Për rrjedhojë, vlerësimi i Komisionit, për të konsideruar huadhënësin, z. K., person tjetër të lidhur, është i bazuar në ligj. Po ashtu, në kushtet që ky individ ka konfirmuar marrëdhënien e huas, së bashku me subjektin e rivlerësimit, ka detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë.

17.8. Subjekti pretendoi edhe që gjendet në kushtet e pamundësisë së sigurimit të dokumentacionit për të provuar mundësinë e huadhënësit për të financuar huan me burime të ligjshme. Trupi gjykues vëren se ky pretendim është i pabazuar në ligj. Konkretisht, referuar nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në mënyrë që të vërtetohet kjo situatë, subjekti është i detyruar të provojë përpara organeve të rivlerësimit se: (i) dokumenti është zhdukur; (ii) ka humbur; (iii) nuk mund të bëhet përsëri; ose (iv) nuk mund të merret në rrugë tjetër. Në rrethanat konkrete, jo vetëm që subjekti nuk ka specifikuar cila prej këtyre situatave gjen zbatim në rastin e dokumentacionit justifikues për të ardhurat e personit tjetër të lidhur, por në të njëjtën kohë nuk rezulton në aktet në fashikuj asnjë përpjekje e tij për të marrë dokumentacion provues, për të ardhurat e personit tjetër të lidhur. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të Komisionit, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale konfirmuese të huas<sup>43</sup>, në të cilën huadhënësi ka deklaruar se huaja ka pasur për burim kursime të familjarëve nga puna e kryer në Shqipëri dhe emigracioni në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (në vijim “ShBA”). Nuk rezulton asnjë dokumentacion për të dokumentuar këto të ardhura përpos deklaratës së sipërreferuar.

17.9. Komisioni ka administruar dy vërtetime nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për të ardhurat e prindërve të huadhënësit në vitet 1994-2005. Shuma e referuar në këto akte, sikurse në Komision, u përfshi edhe në analizën financiare të kryer në Kolegj kundrejt financimit të huas prej 15.000 USD, meqenëse huadhënësi ka rezultuar në një certifikatë familjare me prindërit. Nga kjo analizë u konfirmua rezultati negativ për të mundësuar huadhënien me burime të ligjshme, në vlerën (-) 871.274 lekë.

17.10. Për sa më lart, nga kontrolli i analizës së vendimit të Komisionit, Kolegji konkludon se pretendimet e subjektit lidhur me këtë pasuri nuk qëndrojnë. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar saktë në deklaratën e pasurisë *vetting* burimin që ka shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, në kushtet që kredia është miratuar pasi subjekti kishte shlyer pagesën e apartamentit tërësisht.

---

<sup>41</sup> [4.] Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. [...]”.

<sup>42</sup> Udhëzimi nr. 4095, datë 10.10.2016, Fletorja Zyrtare nr. 187, viti 2016. Pika 7 e Udhëzimit përcakton: “[7] Për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, duhet të deklarojë burimin, në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre”.

<sup>43</sup> Të datës 13.07.2020.

Gjithashtu, subjekti nuk provoi as mundësinë e huadhënësit për të kontribuar vlerën 15.000 USD, për shlyerjen e apartamentit me burime të ligjshme. Për rrjedhojë, subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë, në kundërshtim me përcaktimin e germës “a” dhe të mungesës së burimeve të ligjshme, parashikuar në germën “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

18. *Për huadhënien në vlerën 10.000 euro në vitin 2014*

18.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar se i ka dhënë hua motrës 10.000 euro në vitin 2014, pa interes dhe pa afat, nëpërmjet një marrëveshjeje verbale. Si burim për huan, subjekti ka deklaruar *kursimet nga paga*. Nga analiza financiare e kryer, Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e kësaj shume, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

18.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshton këtë konkluzion, duke kërkuar nga Kolegji që në analizën financiare të përfshihen disa të ardhura dhe të përjashtohen apo reduktohen disa të tjera. Konkretisht, subjekti kërkoi të përfshihen: (i) të ardhurat e tij nga puna për vitet 2001-2004, të ardhurat e bashkëshortes nga puna që nga viti 2002, “të hollat” e dhuruara për martesë në vitin 2005 dhe dhuratat (*në cash*) për lindjen e fëmijëve në vitet 2006 dhe 2010; (ii) vlera 56.000 lekë nga shitja e automjetit të bashkëshortes tip “Fiat Punto”. Nga ana tjetër, subjekti kërkon të *mos* përfshihen shpenzimet në vlerën 5.000 euro, referuar në preventivin e punimeve për apartamentin në Durrës [hartuar nga sipërmarrësi, analizuar më sipër] në vitin 2007 dhe as shumat e përdorura për shlyerjen e kredisë për vitet 2007-2014, meqenëse ato janë përballuar nga i ati. *Së fundmi*, subjekti kërkon të përllogariten shpenzime më të ulëta jetike për familjen e tij meqenëse jetonte në Berat, duke përllogaritur vetëm 136.620 lekë dhe jo 235.968 lekë.

18.3. Pasi analizoi aktet në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se pretendimet e subjektit nuk janë të bazuara, ndërsa konkluzioni i Komisionit është i drejtë. Edhe në analizën e kryer në Kolegj, u konfirmua balanca negative e konstatuar nga Komisioni kundrejt krijimit të kësaj shume me burime të ligjshme. Konkluzioni i trupit gjykues bazohet në analizën e shtjelluar në vijim.

18.4. *Së pari*, trupi gjykues çmon të theksojë se subjekti ka plotësuar një deklaratë periodike vjetore si Oficer i Policisë Gjyqësore (në vijim “OPGj”) për vitin 2004, në mars 2005. Në vijim, subjekti ka kryer deklaratë para fillimit të detyrës si *prokuror*, në korrik 2014, sikurse edhe deklaratat periodike për vitet përkatëse në periudhën e mëpasme [2014-2016] dhe deklaratën e pasurisë për rivlerësimin [*vetting*]. Nga analiza e këtyre akteve, rezulton se subjekti ka qenë kontradiktor për sa i përket burimit të krijimit të pasurisë objekt analize. *Së dyti*, në deklaratën para fillimit të detyrës si *prokuror*, që mban datën 14.07.2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një depozitë në BKT, në vlerën 10.000 euro, me burim “kursime nga paga në 13 vite punë”. Në ndryshim nga kjo deklaratë, në atë të dorëzuar në mars 2005 (sipërcituar) si OPGj, subjekti *nuk* ka deklaruar kursime në *cash* nga punësimi i mëparshëm, që prezumon të mos ketë pasur kursime në *cash* nga periudha përpara vitit 2004. *Së treti*, në deklaratën periodike/vjetore për vitin 2014, depozituar në shkurt 2015, subjekti ka deklaruar si burim krijimi të huas “tërheqje nga depozita pranë BKT – 50%”. Një vit më pas, pyetur nga ILDKPKI-ja në 17 mars 2016, ndryshe nga deklarata e parë si *prokuror* [para fillimit të detyrës, në korrik 2014], subjekti e ka kufizuar harkun kohor të krijimit të kësaj pasurie/depozite në të ardhurat nga viti 2005 deri në 20.06.2014 që janë nga paga e ime në funksionin e OPGj-së nga viti 2005 deri më 20.06.2014, kur u emërova

*prokuror, si dhe nga paga e bashkëshortes si mësuese në shkollën “{\*\*\*}”, në Berat, nga viti 2002<sup>44</sup>. Së fundmi, në deklaratën vetting subjekti nuk ka specifikuar periudhën kohore gjatë të cilës janë krijuar këto fonde, duke u shprehur vetëm për “kursime nga paga”.*

**18.5.** Nga dokumentacioni i përcjellë nga BKT-ja<sup>45</sup> konstatohet se në datën 07.07.2014 – një javë përpara plotësimit të deklaratës së interesave private para fillimit të detyrës si prokuror – subjekti ka depozituar *cash* në vlerën 10.000 euro. Një ditë më pas kjo shumë është vendosur në depozitë me afat deri në shator të atij viti. Edhe në ato akte, është deklaruar si burim “kursime nga paga 13 vite pune”. Nga e njëjta shkresë e BKT-së, rezulton se subjekti e ka tërhequr këtë shumë në *cash* si vijon: (i) në datën 01.09.2014 shumën 1.999,29 euro; (ii) në datën 17.09.2014 shumën 4.000 euro; dhe (iii) në datën 24.10.2014 shumën 4.001,42 euro. Në total, këto tre tërheqje, në vlerën 10.000,71 euro, janë kryer mes 1 shtatorit dhe 24 tetorit 2014.

**18.6.** Meqenëse kjo vlerë është krijuar para fillimit të detyrës, sikurse edhe në Komision, analiza mbi mundësinë financiare në Kolegj u krye duke përfshirë të ardhurat e subjektit nga puna që nga viti 2001 deri në datën 07.07.2014, kur ai ka depozituar shumën në fjalë. Në këtë analizë, sikurse edhe atë të kryer nga Komisioni, rezultoi një balancë negative në vlerën (-) 3.158.331 lekësh. Duke marrë në konsideratë pretendimet e subjektit në ankim, Kolegji analizoi edhe mundësinë financiare të tij për të krijuar kursimet në vlerën 400.000 lekë -- deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës si prokuror në vitin 2014 -- për blerjen e dy automjeteve dhe përballimin e shpenzimeve të tjera.

**18.7.** Në këtë analizë, nën dritën e parashikimit nga neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, për vlerën provuese që kanë deklaratat periodike vjetore të plotësuara sipas ligjit nr. 9049/2003, trupi gjykues mbajti në konsideratë që në deklaratën e depozituar nga subjekti në mars 2005, pas emërimit në detyrën e Oficerit të Policisë Gjyqësore nuk rezultojnë kursime në *cash* nga punësimi në vitet 2001-2004<sup>46</sup>. Për këto arsye, sikurse edhe Komisioni, trupi gjykues përfshiu në përlllogaritje pagat për vitet 2004 e në vijim<sup>47</sup>. Në kushtet që subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash* në vitin 2004, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se është e drejtë të prezumohen se të ardhurat në vlerat përkatëse kanë shërbyer për të mbuluar shpenzime të tjera<sup>48</sup>, sikurse edhe ato të jetesës. Ky vlerësim i hershëm duket se vjen në të njëjtën linjë logjike edhe me deklaratimet e tij të mëpasme, në ILDKPKI dhe me deklaratën *vetting*, ku kursimet nga paga janë kufizuar përkatësisht në periudhën 2004 e në vijim, sikurse edhe nuk ka pasur specifikim për kursime të mëhershme.

**18.8.** Në analizë të periudhës së kontrolluar, kursimet e deklaruara *cash* 400.000 lekë në deklaratën e para fillimit të detyrës, në vitin 2014, që përfshijnë të gjithë periudhën e punësimit, u përfshinë në analizë nga Kolegji. Kjo periudhë përfshin të ardhurat e deklaruara *cash* nga deklarimi i parë në vitin 2004 deri në deklarimin e vitit 2014. Pas kontrollit të analizës në Kolegj, u konfirmua *pamundësia* e subjektit për të kursyer këtë vlerë.

---

<sup>44</sup> Përgjigja e pyetjes nr. 3 të inspektore E. D., faqja 2 e procesverbalit të mbajtur në ILDKPKI në datën 17.03.2016, kopjuar tekstualisht nga akti.

<sup>45</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 28.10.2019.

<sup>46</sup> Nga aktet rezulton se subjekti ka qenë i punësuar në Prefekturën e Qarkut Berat për periudhën korrik 2001 – dhjetor 2004. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit ka qenë edhe anëtar i KRRT-së së Komunës {\*\*\*}, në Berat, nga viti 2003-2005, ku edhe është paguar si jurist i jashtëm.

<sup>47</sup> Pasqyruar në pikë 2.22 të vendimit të Komisionit, i cili referon paragrafin 10.26 të rezultateve të hetimit administrativ dhe Aneksin 01 të analizës financiare të përcjellë me të.

<sup>48</sup> Subjekti ka deklaruar në ILDKPKI në mars 2016, ndër të tjera, edhe blerjen e një automjeti tip “Mercedes-Benz”, në korrik 2004 me të ardhurat nga punësimi në vitet 2001-2004. Referuar në paragrafin 8.20 të rezultateve të hetimit administrativ, sikurse edhe pasqyruar në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në 17.03.2016, përgjigja e pyetjes nr. 1.

18.9. Ndryshe nga sa pretendon subjekti, të ardhurat e bashkëshortes nga viti 2002-2004 Komisioni i ka përfshirë në analizën financiare të familjes së bashkëshortes, ndërsa të ardhurat e saj nga data 01.01.2005 janë përfshirë në analizën financiare të familjes së subjektit, meqenëse subjekti ka deklaruar se ka nisur jetesën e përbashkët në vitin 2005. Nga kontrolli i vendimit, Kolegji e çmon të drejtë analizën e Komisionit për të mos i përfshirë në të ardhurat e subjektit, pagat e bashkëshortes së tij nga viti 2002-2004, kur nuk u pretendua as provua bashkëjetesa apo dërgimi i këtyre vlerave nga bashkëshortja në familjen e subjektit. Po ashtu, duke mbajtur në konsideratë faktin që vlerat janë të ulëta, Kolegji konstatoi që edhe pse ato janë përfshirë në analizën financiare të familjes bashkëshortes së subjektit, në këto dy vite 2002-2004, familja e saj rezultoi në pamundësi kursimi, çka përjashton edhe mundësinë që të jenë dërguar në ndonjë mënyrë në familjen e subjektit.

18.10. Subjekti pretendon se ndër vite ka marr dhurata në *cash* për shkak të ngjarjeve familjare, si martesë apo lindjet e fëmijëve, pa specifikuar një vlerë në total. Trupi gjykues e gjen të pabesueshëm këtë pretendim, *së pari* pasi ai nuk shoqërohet me një vlerë financiare qoftë edhe të përafërt, gjë që e bën ekzistencën e tyre as edhe deklarative. *Së dyti*, këto dhurata nuk kanë lënë asnjë gjurmë në asnjë dokument të kohës apo në vijim. Trupi gjykues konstatoi se të ardhurat e pretenduara nga dhuratat në *cash* për martesë në vitin 2005 dhe për lindje të fëmijëve në vitet 2006 dhe 2010, nuk janë deklaruar në deklaratat periodike, në deklaratën e pasurisë *vetting* apo si pikë fundore, gjatë hetimit administrativ. Konkretisht, referuar përgjigjeve të dhëna gjatë hetimit administrativ, rezulton se në pyetësin nr. 1, kur është pyetur nëse ka marrë dhurata me vlerë më të lartë se 500 euro, subjekti është përgjigjur negativisht. Për herë të parë, subjekti ka pretenduar ekzistencën e tyre, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, në të cilin pasqyrohej një balancë negative e konsiderueshme. Në përmbledhje të gjithë këtyre aspekteve të marra në analizë, trupi gjykues, sikurse Komisioni, nuk e gjen të bazuar këtë pretendim, sikurse edhe të pamundur të përllogarisë në analizën financiare një kontribut financiar në vlerë të panjohur.

18.11. Në kushtet që për qëllimet e këtij ligji, sipas pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pasuri të ligjshme konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar, kursimet e dhurimet e analizuara më sipër nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, qoftë në deklaratën e interesave private për vitin 2004, në atë të fillimit të detyrës në vitin 2014 dhe as në deklaratën e pasurisë *vetting*, *ekzistenca* e tyre u vlerësua me natyrë deklarative/e paprovuar edhe në vlerësimin e kryer në Kolegji. Për rrjedhojë, është i drejtë e i bazuar konkluzioni i Komisionit për mospërfshirjen e këtyre të ardhurave për të cilat nuk gjenden gjurmë në deklaratimet periodike të subjektit ndër vite apo në deklaratën e pasurisë *vetting*. Pretendimi i subjektit u gjet i pabazuar.

(a) *Përfshirja e vlerës së fituar nga shitja e automjetit në pronësi të bashkëshortes*

18.12. Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat që kanë rezultuar nga diferenca midis çmimit të shitjes dhe atij të blerjes së një automjeti [“Fiat Punto”], me arsyetimin se nuk janë shlyer detyrimet tatimore për fitimin nga kjo diferencë.

18.13. Subjekti nuk është dakord me këtë qëndrim të Komisionit dhe potencon se nuk kishte detyrim deklarimi sipas ligjit nr. 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, i shfuqizuar (në vijim “ligji nr. 8438/1998”). Sipas subjektit, meqenëse ligji nr. 8438/1998 nuk parashikon shprehimisht që fitimi midis diferencës së çmimit të shitjes me çmimin e blerjes është e ardhur që duhet të tatohet, Komisioni nuk mund ta kategorizojë atë diferencë si e ardhur e tatueshme.

**18.14.** Nga analiza e bazës ligjore që gjen zbatim -- sipas nenit 8 të ligjit nr. 8438/1998 dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, cituar e referuar më sipër edhe nga subjekti -- rezulton se të ardhurat nga shitja e automjeteve për përdorim personal nuk i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat personale. Ky vlerësim është argumentuar edhe më herët në praktikën e Kolegjit<sup>49</sup>, mbështetur edhe në shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (në vijim “DPT”)<sup>50</sup>. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim i subjektit është i bazuar. Në analizën e kryer në Kolegj, për burimet e ligjshme që kanë shërbyer për huadhënien objekt analize, ndër të ardhurat e subjektit u përfshi edhe vlera përkatëse [56.000 lekë].

**18.15.** Nga aktet në fashikull rezulton se subjekti e ka ngritur pretendimin për të përfshirë në analizën financiare të ardhurat nga automjeti në fjalë që në rezultatet e hetimit, duke theksuar se nuk kishte detyrim tatimi sipas ligjit nr. 8438/1998. Po nga aktet rezulton se automjeti është blerë nga bashkëshortja e subjektit në vlerën 144.000 lekë, sipas faturës tatimore datë 17.2.2012 dhe është shitur 200.000 lekë me një kontratën noteriale që mban datën 11.04.2014. Siç rezulton nga këto akte, diferenca midis çmimit të shitjes me atë të blerjes është në vlerën 56.000 lekë. Bashkëshortja e subjektit e ka përdorur teorikisht mjetin për më shumë se dy vite.

**18.16.** Nën dritën e sa më sipër, pyetja logjike që do të duhet të ishte shtruar dhe kërkuar shpjegime nga subjekti do të duhet të ishte fokusuar mbi mungesën [të paktën në dukje] e logjikës ekonomike që shoqëron këtë transaksion e, konkretisht, që subjekti dhe personi i lidhur fituan 38% mbi vlerën e blerjes, pasi automjeti u përdor edhe 26 muaj të tjerë. Komisioni *nuk* rezulton të ketë hetuar për këtë fakt, duke u kufizuar vetëm në interpretimin e nenit 8 të ligjit nr. 8438/1998, për të konkluduar drejt mospërfshirjes së vlerës së fituar. Në këto kushte, trupi gjykues vëren se sipas normimit ligjor të sipërreferuar, praktikës së Kolegjit dhe praktikës së ndjekur nga DPT-ja, referuar në korrespondencën zyrtare me Kolegjin, fitimi i gjeneruar nga shitja e automjetit u përfshi në analizën financiare kundrejt mundësisë së subjektit për të krijuar vlerën 10.000 euro, për krijimin e depozitës dhe dhënien hua motrës.

*(b) Për vlerat e kësteve të kredisë*

**18.17.** Në analizën financiare për mundësinë e huadhënies, subjekti ka kërkuar të zbriten shpenzimet për gjashtë këste kredie për apartamentin në Durrës, që sipas tij janë shlyer nga i ati, duke filluar nga korriku 2014. Komisioni ka vlerësuar të mos e pranojë këtë pretendim duke mbajtur në konsideratë që deri në vitin 2014 subjekti e prindërit kanë qenë në ekonomi të përbashkët familjare. Për periudhën pas vitit 2014, Komisioni ka potencuar se përfitimi financiar në fjalë, nëpërmjet përballimit të këtyre pagesave nga i ati, nuk ka gjetur pasqyrim në deklaratën periodike vjetore përkatëse, në rubrikën “dhurata dhe trajtime preferenciale”. Për rrjedhojë, Komisioni nuk ka zbritur nga analiza financiare e subjektit dhe personit të lidhur/bashkëshortes shpenzimet për pagesën e kësteve të kredisë.

**18.18.** Të njëjtin argument subjekti e ka ngritur edhe në ankimin në Kolegj, duke ritheksuar natyrën e përbashkët të ekonomisë së tij familjare me prindërit. Subjekti pretendon se prindërit kanë financuar një pjesë të kësteve të kredisë edhe meqenëse apartamenti është blerë në mënyrë që ta përdorin ata pas daljes në pension.

---

<sup>49</sup> Shih, ndër të tjerë, vendimin e Kolegjit (JR) nr. 15/2021, që i përket subjektit të rivlerësimit Kastriot Selita, vendimin e Kolegjit (JR) nr. 41/2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Eda Kaja dhe vendimin e Kolegjit (JR) nr. 26/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Gentiana Xhelili.

<sup>50</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 25.05.2023, “Kthim përgjigje”, drejtuar Kolegjit.



**18.19.** Nga analiza e akteve në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit, sikurse edhe Komisioni, arriti në përfundimin që ky pretendim i subjektit është i pabazuar. Edhe në analizën e kryer në Kolegj, u konfirmuan zërat përkatës financiarë sipas vlerësimit të Komisionit. Në këtë konkluzion, trupi gjykues i Kolegjit mbajti në konsideratë, qoftë faktin që në kushtet e ekonomisë së përbashkët familjare të subjektit më prindërit, pagesat e përballuara nga prindërit nuk e ndryshojnë balancën negative. Pretendimi i subjektit për përballimin e shpenzimeve nga prindërit për periudhën pas shkëputjes së tij nga ekonomia e përbashkët me ta, duket jobindës e si një përpjekje për të përmirësuar situatën e balancës negative me të cilën subjekti është njohur dhe jo si pasqyrim i së vërtetës. Nga aktet rezulton që subjekti ka shlyer nga llogaria e tij 37 këste, të tretë [persona të tjerë] kanë shlyer katër (4) këste, ndërsa i ati 53 këste, nga të cilët 29 pas korrikut 2014. Nëse ndiqet logjika e prezantuar prej tij se fondet e paguara janë përballuar nga paguesi përkatës, do të rezultonte që katër këstet e paguara nga individë të tretë janë përballuar prej tyre e duhet të zbriten nga analiza financiare e subjektit – edhe duke abstraguuar nga pyetjet mbi arsyen e kryerjes së pagesave nga të tretë. Nga ana tjetër, subjekti nuk duket të ketë treguar pjesë takuese të interesave pasurore të prindërve mbi këtë apartament apo ndërthurjen e papërcaktuar për shkak të marrëdhënies së ngushtë të interesave pasurore të tij me prindërit, qoftë duke filluar nga momenti kur u bë subjekt deklarues si prokuror e u shkëput nga ekonomia e përbashkët familjare apo në deklaratën e pasurisë *vetting*.

**18.20.** Për sa më sipër, analiza financiare e kryer nga Komisioni për këtë zë shpenzimesh u konfirmua. Për periudhën deri në vitin 2014, analiza financiare e kryer përfshin edhe të ardhurat e prindërve të subjektit, ndërsa për kohën pas ndarjes së tij nga ekonomia familjare, pretendimet e subjektit nuk kanë gjetur pasqyrim në akte të kohës, sikurse do të ishte deklarimi sipas detyrimeve të parashikuara nga germa “f”, pika 1, e nenit 4 e ligjit nr. 9049/2003<sup>51</sup>.

*(c) Vlera e punimeve për rikonstruksionin e apartamentit në Durrës*

**18.21.** Komisioni nuk e mori në konsideratë pretendimin e subjektit se shpenzimet në shumën 5.000 euro, për punime në apartamentin në Durrës, nuk u kryen, duke vlerësuar se subjekti nuk shpjegoi bindshëm të kundërtën e dokumentacionit të administruar nga banka kredituese për këto punime. Po ashtu, Komisioni potencon se kryerja e këtij shpenzimi është e arsyeshme duke mbajtur në konsideratë që vlera e shitjes së apartamentit është e ulët krahasuar me kostot mesatare të ndërtimit për vitin 2007. Edhe në Kolegj, subjekti pretendon se nuk e ka investuar vlerën 5.000 euro në vitin 2007 e, si rrjedhojë, nuk duhet t’i përfshihet si shpenzim në analizën e mundësisë së huadhënies motrës.

**18.22.** Nga analiza e kryer, mbi bazën e dokumentacionit në fashikull dhe dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, përfshirë edhe pikën 4, të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016 [cituar më sipër në paragrafin 18.19], trupi gjykues i Kolegjit mbërriti në konkluzionin që vlerësimi i Komisionit është i bazuar, ndërsa pretendimi i subjektit është jobindës, pasi bie ndesh me dokumentacionin shkresor të përcjellë nga vetë ai [subjekti] edhe gjatë procesit të hetimit administrativ. Përkundër pretendimit të subjektit se ky shpenzim në fakt nuk është kryer, trupi gjykues i Kolegjit mbajti në konsideratë vlerën provuese të akteve shkresore, të cilat sugjerojnë të kundërtën dhe njëkohësisht janë në

---

<sup>51</sup>Neni 4 i ligjit përcakton: “Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] (f) dhuratat dhe trajtimet preferenciale, përfshirë identitetin e personit fizik ose juridik, prej nga vijnë apo krijohen dhuratat a trajtimet preferenciale. [...]”.

harmoni logjike me shpjegimet e dhëna nga subjekti në hetimin administrativ. Arsyetimi i Kolegjit shtjellohet në detaj në vijim.

**18.23.** *Së pari*, nga aktet rezulton që subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën para fillimit të detyrës si prokuror, në vitin 2014, duke specifikuar vlerën 15.000 euro dhe si burim kredinë në Alpha Bank, trajtuar më lart. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit depozitoi në cilësinë e provës shkresore në Komision, një akt të titulluar “Preventiv”, që mban datën 15.10.2007, për punime me një vlerë në total prej 659.250 lekësh ose ekuivalenti prej 5.000 eurosh. Sipas këtij akti të paraqitur nga subjekti dhe referuar edhe në kontratën e kredisë, apartamenti në atë moment kohor ka pasur nevojë për punime me natyrë thelbësore – si prishje punimesh aktuale dhe rikryerje të një sërë veprimesh. Nga ana tjetër, në kontratën e kredisë Alpha Bank merr përsipër të çelë në favor të kredimarrësit, subjektit dhe bashkëshortes, kufi kredie në shumën 18.300 euro, ndërsa projekti i blerjes dhe rikonstruksionit të apartamentit ka kosto totale 20.000 euro nga të cilat “5.000 euro do të jenë kontribut nga kredimarrësi”<sup>52</sup>. Me fjalë të tjera, vlera e preventivit në masën 5.000 euro ose 659,250 lekë, do të investohen nga subjekti i rivlerësimit, ndërsa pjesa tjetër nga kredia. Kontrata e kredisë, në pikën 3.1, po ashtu, parashikon në mënyrë të shprehur që huaja jepet me kusht që financimi i pjesës tjetër të projektit të bëhet vetëm me kontribute të kredimarrësit dhe jo me financime nga të tretët.

**18.24.** Nga analiza e akteve të mësipërme, rezultojnë disa elementë. *Së dyti*, subjekti ka pretenduar pranë huadhënësit në momentin e marrjes së kredisë që apartamenti kishte nevojë për një tërësi investimesh që përbënin 25% të vlerës së tij në total. Kredia është disbursuar mbi bazën e kësaj pasqyre faktesh të cilat kanë përbërë edhe kusht të domosdoshëm. Në pikën 3.3 të kontratës së sipërreferuar, banka/huadhënësi shprehet se nëse kostoja e projektit është më e ulët sesa ajo e parashikuar, edhe vlera e kredisë do të ulet. Subjekti nuk rezulton të ketë sjellë akte të tjera që mund të mbështesin një pasqyrë të ndryshme të gjendjes së apartamentit apo të nevojës së ndryshuar për punime për çfarëdolloj arsyeje apo të uljes së vlerës së kredisë. Kredia është disbursuar në vlerën 15.000 euro, sipas dakordësisë, në datën 17.10.2007.

**18.25.** Duke abstraguar nga çfarë deduktohet nga mungesa e mirëbesimit dhe paraqitja e fakteve të pavërteta për të përfituar kredinë, që subjekti kërkon të pranohet për të përmirësuar situatën financiare të vitit 2007, në këtë fazë të procesit, trupi gjykues i Kolegjit çmoi të theksojë mungesën e dokumentacionit që do të provonte pretendimin e subjektit për rrethana faktike të ndryshme nga ato që rezultojnë sipas akteve. Për rrjedhojë, duke u fokusuar te shkaqet e ankimit, në kushtet që subjekti nuk provoi që ky investim nuk u krye sipas qëllimit të kontratës, vlera 5.000 euro, edhe në analizën e kryer në Kolegji, u konsiderua si shpenzim në vitin 2007.

**18.26.** Për sa më lart, trupi gjykues i Kolegjit arriti në përfundimin që subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të mbështesë me dokumentacion ligjor pretendimet e ngritura në ankim në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer për të krijuar depozitën bankare, deklaruar si burim për dhënien e huas në vlerën 10.000 euro së motrës. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare që me të ardhura të ligjshme të krijojnë këtë pasuri, të përballonin shpenzimet e të krijojnë kursimet në *cash* të deklaruara për periudhën kohore 2005-2014, duke u gjendur në situatën e parashikuar në germën “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Nga

---

<sup>52</sup> Pikat 2.2 dhe 2.3 të kontratës së kredisë shumëqëllimore lidhur nga subjekti i rivlerësimit [e bashkëshortja] dhe Alpha Bank, Berat, nr. {\*\*\*}, datë 17.10.2007.

analiza e kryer mbi bazën e shkaqeve të ankimit, balanca negative e konstatuar nga Komisioni konfirmohet.

#### 19. *Huadhënie prindërve në shumën 7.000 euro*

19.1. Subjekti ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhënien e kësaj huaje prindërve, në vitin 2016, me burim kursime nga paga. Të njëjtën hua ai e ka deklaruar në deklaratën periodike për vitin 2016, me ndryshimin që si burim ka referuar të ardhurat e fituara nga *shitja e një automjeti* në datën 29.09.2016. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti nuk kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e kësaj huaje dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera, duke rezultuar me balancë negative prej (-) 436.577 lekësh, për vitin 2016. Në këtë konkluzion, Komisioni mbërriti pasi nuk përfshiu në analizë financiare: (i) diferencën e përfshuar nga çmimi i blerjes me atë të shitjes së automjetit tip BMW [me targë {\*\*\*}] më datë 29.09.2016; dhe as (ii) pretendimin e subjektit për të përlllogaritur shpenzime jetese më të ulëta gjatë vitit shkollor për fëmijët, për shkak të disa përfitimeve me natyrë financiare që ata kanë përfituar.

19.2. Me analizën e mësipërme nuk është dakord subjekti i rivlerësimit. Ai kërkon nga Kolegji të përfshihen në analizën financiare edhe të ardhurat/diferenca midis çmimit të shitjes me atë të blerjes së automjetit tip BMW, në masën 161.310 lekë<sup>53</sup>. Gjithashtu, sikurse në Komision, edhe në Kolegji, subjekti kërkoi reduktimin e shpenzimeve të jetesës për muajt e vitit akademik për dy fëmijët e tij, të cilët kanë qenë në shkollë private. Sipas pretendimeve në ankim, pjesa më e madhe e shpenzimeve mbuloheshin nga pagesa e shkollës. Për të mbështetur këtë kërkim, në ankim subjekti depozitoi një vërtetim [të dytë] të lëshuar nga institucioni arsimor<sup>54</sup>, në të cilin pasqyrohen të dhëna të ndryshme nga ato të referuara në shkresat e dërguara gjatë hetimit, më 22.10.2019. Konkretisht, në shkresën e dytë, datë 08.03.2021, institucioni arsimor në fjalë, referon në të njëjtën linjë me sa pretendon subjekti në ankim se shkolla përballon më tepër shpenzime sesa rezultinin nga shkresa e parë: arsimimin, transportin dhe *dy vakte* ushqimore.

19.3. Pas verifikimit të akteve në fashikull dhe pas kontrollit të analizës së Komisionit, sipas pretendimeve që lidhen me mundësinë e dhënies së huas prindërve, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare për të justifikuar plotësisht dhënien e kësaj huaje në vitin 2016, në vlerën 7.000 euro, si dhe për të përballuar shpenzimet e jetesës me të ardhura të ligjshme. Në të njëjtën kohë, Kolegji nënvizon deklaratimet e pasakta dhe kontradiktore të subjektit, lidhur me burimin që shërbeu për dhënien e huas. Ky konkluzion bazohet në analizën që shtjellohet në vijim.

19.4. *Së pari*, nga aktet në fashikull referuar më sipër, rezulton se subjekti ka deklaruar burime të ndryshme për krijimin e huas dhënë prindërve pa interes. Konkretisht, ndërsa në deklaratën e pasurisë *vetting* -- plotësuar në datën 26.01.2017 -- subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi kursimet nga *paga*, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, plotësuar pas deklaratës *vetting* – më 29.03.2017 -- subjekti ka deklaruar si burim krijimi të ardhurat nga *shitja e automjetit tip BMW* datë 29.09.2016. Në të njëjtën linjë me deklaratën për vitin 2016, subjekti rezulton të ketë gjetur hapësirë të deklarojë burimin e huas prindërve në pyetësin nr. 1, në një pyetje që

<sup>53</sup> Subjekti referon vendimin e Kolegjit (JR) nr. 12/2018, që i përket subjektit të rivlerësimit Bashkim Dedja.

<sup>54</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., nga shkolla jopublike "{\*\*\*}", Berat.

lidhej vetëm *me shpenzime* të cilat kapërcejnë vlerën 2.500 euro<sup>55</sup>. Nga i njëjti pyetësor, dërguar në Komision më 28.10.2019, rezulton se subjekti i ka lidhur kursimet nga paga tashmë me blerjen e tri (3) automjeteve të tjera, përkatësisht në vitet 2017, 2018 dhe 2019.

19.5. Nga sa më sipër, rezulton që subjekti ka rishikuar/modifikuar burimet financiare të identifikuar në funksion të huadhënies prej 7.000 eurosh prindërve, mes deklaratës *vetting* dhe deklaramit periodik të radhës në vijim ose e thënë ndryshe në periudhën kohore mes janarit dhe marsit 2017 e në vijim, në procesin e hetimit administrativ. Nga ana tjetër, situata e paraqitur nga subjekti rezulton kontradiktore nëse krahasohen pretendimet e tij në shkaktun e mësipërm të ankimit – se babai kishte mjete financiare të cilat i lejonin të shlyente pagesat e kredisë së apartamentit të subjektit – ndërsa njëkohësisht kishte nevojë për likuiditetet dhënë hua nga subjekti apo nën dritën e faktit që po në vitin 2016 ka përfutuar të ardhura ekuivalente me huan e marrë nga subjekti nga shitja e një automjeti<sup>56</sup>, sikurse edhe transaksione të tjera shitblerjeje automjetesh me fitime të konsiderueshme, të cilat nuk janë objekt i drejtpërdrejtë i analizës<sup>57</sup> për një sërë arsyesh, përfshirë edhe ato procedurale.

19.6. Në aktet në fashikull nuk rezulton të ketë shpjegime prej tij [subjektit] për modifikimin e burimit të përdorur për huadhënien. Po ashtu, dhe duke abstraguar nga fakti që analogjia me qëndrimin e Kolegjit në çështjen (JR) nr. 12/2018 përjashtohet, pasi flitet për fitime nga marrëdhënie të ndryshme juridike -- tatimi mbi të ardhurat nga huadhënia e likuiditeteve monetare kundrejt fitimit të gjeneruar nga shitja e një automjeti -- ky aspekt mbetet jorelevant nën dritën e qëndrimit dhe konstatimeve të trupit gjykues të Kolegjit, shtjelluar më sipër në këtë vendim në paragrafët 18.12 deri në 18.16, në lidhje me fitimin nga shitja e një automjeti tjetër, sikurse edhe këndvështrimin e analizës që ka munguar gjatë hetimit të kryer nga Komisioni për logjikën ekonomike të rritjes së vlerës së një automjeti pas përdorimit të mëtejshëm. Për rrjedhojë dhe pa përsëritur sa është arsyetuar më sipër, si dhe nën dritën e garancive procedurale të subjektit në ankim, në analizën e kryer në Kolegj, vlera prej *161.310 lekësh*, e rezultuar si diferencë mes çmimit të shitjes e atij të blerjes së këtij automjeti<sup>58</sup>, u përfshi në të ardhurat në dispozicion të subjektit kundrejt mundësisë për të mbuluar shpenzimet dhe financuar huadhënien prindërve në vitin 2016.

19.7. *Së dyti*, trupi gjykues i Kolegjit vëren se kërkesa e subjektit për të zbritur *shpenzimet jetike* për fëmijët, meqenëse, sipas tij, në shtëpi ata konsumonin vetëm *një vakt ushqimor* gjatë vitit akademik, rezulton e pabazuar, ndërsa përlllogaritja e kryer nga Komisioni për shpenzimet jetesës është i drejtë. Edhe duke abstraguar nga elementët e tjerë proceduralë të referuar më sipër [paragrafët 9.5 dhe 9.6] për aktet e sjella për herë të parë në ankim, vërtetimet e institucionit arsimor janë kontradiktore për sa i përket shpenzimeve nga të cilat fëmijët e subjektit kanë qenë të përjashtuar. Konkretisht, ndërsa vërtetimi i datës 22.10.2019 referon që fëmijët e subjektit të rivlerësimin kanë qenë të përjashtuar nga *tarifa e shkollimit*, në shkresën e datës 08.03.2021, marrë prej subjektit *pasi* ai është njohur me vendimin e Komisionit [dhe bashkëlidhur ankimit],

---

<sup>55</sup> Në përgjigje të pyetjes nr. 9, që lidhet me *shpenzime*, subjekti referon si burim të të ardhurave për huan e dhënë prindërve shitjen e një automjeti [tip BMW me targë {\*\*\*}], në vlerën 7.000 euro, në datën 29.09.2016.

<sup>56</sup> Kontrata e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 07.11.2016, BMW X5, me targë {\*\*\*} [shitës babai i subjektit], çmimi 7.000 euro, blerë në datën 25.06.2014, për 500.000 lekë.

<sup>57</sup> Babai i subjektit, në datën 04.04.2017, ka blerë autoveturën tip BMW, në vlerën 2.500 euro, për të cilën polica e sigurimit datë 19.03.2017, sipas dokumentacionit të përcjellë nga DPSHTRR-ja është lëshuar në emër të subjektit të rivlerësimit si pronar dhe përdorues, por jo në emër të babait siç rezulton nga kontrata. Automjeti është shitur tre muaj më pas, me vlerë të shtuar 200% -- për 5.500 euro.

<sup>58</sup> Diferenca në lekë mes 7.000 eurove të shitjes e 800.000 lekë të vlerës së shpenzuar për blerjen.

pasqyrohet që në këto përfitime përfshihet edhe *transporti* dhe *dy vakte ushqimore* të mbuluara nga shkolla. Këto detaje sugjerojnë që subjekti përpiket të paraqesë një situatë të ndryshme nga ajo e konstatuar nga Komisioni në vendim, në një fazë tejet të avancuar, pasi ai është njohur me vendimin, duke paraqitur një shkresë të hartuar jo në favor të pretendimeve të tij në ankim. Për rrjedhojë, ky vërtetim nuk paraqet vlerë provuese edhe parë në këndvështrimin që abstragon nga problemet procedurale të kohës kur ajo u paraqit.

**19.8.** *Së treti*, nga aktet rezulton që gjithsesi, edhe nëse do të pranohej, ky pretendim do të gjente zbatim vetëm për një nga fëmijët. Në kushtet që njëri prej fëmijëve rezulton të ketë nisur shkollimin në këtë institucion arsimor në vitin 2017, zbritja e kërkuar prej subjektit në shpenzimet e jetesës do të kishte pasoja financiare vetëm pas vitit akademik 2017 e, për pasojë, pa asnjë peshë në analizën për mundësinë e krijimit të shumës 7.000 euro dhënë hua prindërve në vitin 2016.

**19.9.** *Së katërti*, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar mënyrën e përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës që ka kryer Komisioni, bazuar në shkresën me nr. {\*\*\*} prot., datë 04.03.2019, të ILDKPKI-së për periudhën 2000-2016<sup>59</sup>, sipas përbërjes familjare në kohë dhe bazuar në deklaratimet e subjektit në Komision, duke përlllogaritur familjen prej gjashtë (6) anëtarësh deri në 2014 dhe katër (4) anëtarë, duke filluar nga ky vit. Aktet zyrtare, mbi bazën e të cilave Komisioni ka kryer përlllogaritjen e shpenzimeve bazike të jetesës, përbëjnë referencën e përdorur në vijimësi nga institucionet e rivlerësimit, përfshirë edhe Kolegjin. Në mënyrë konsekuente, Kolegji ka përdorur të njëjtat standarde për përlllogaritjen e shpenzimeve jetike, duke theksuar se ato përbëjnë të vetmin burim zyrtar të llojit, por edhe që mbulojnë edhe grupe demografike që përfitojnë pagesa konsiderueshëm më modeste sesa magjistratët. Për rrjedhojë, parametrat e referuar nga INSTAT nuk vlerësohen të padrejta apo se përbëjnë një standard të paarsyeshëm. Në përmbledhje dhe duke mbajtur në konsideratë gjithë aspektet procedurale e faktike të analizuara e konstatuara më sipër, pretendimi i subjektit, për të zbritur një pjesë të shpenzimeve të jetesës për periudha të caktuara kohore, u vlerësua i pabazuar.

**19.10.** Si konkluzion për këtë shkak ankimi, nga sa ka rezultuar nga aktet në dosje, pas kontrollit të analizës së Komisionit, edhe pas analizës së kryer në Kolegj, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare për dhënien e kësaj huaje në vitin 2016 në vlerën 7.000 euro dhe për përbalimin e shpenzimeve të jetesës me të ardhura të ligjshme, sipas germës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

## **20.** *Apartament në pronësi të vjehrrës*<sup>60</sup>

**20.1.** Sikurse referuar më sipër në kontekstin e pretendimeve me objekt procesin e rregullt ligjor [në paragrafin 12 deri 12.6], Komisioni ka hetuar për një apartament në Tiranë, në pronësi të vjehrrës së subjektit, në vijim të një denoncimi nga publiku, që hidhte dyshime se ishte një pasuri e fshehur e subjektit. Pasi i kategorizoi të dhënat në denoncim si indicie për të kryer hetim të

<sup>59</sup> Sipas Komisionit: “Shpenzimet jetike janë përlllogaritur: (i) bazuar në shkresën e ILDKPKI-së me nr. {\*\*\*} prot., datë 04.03.2019, për periudhën 2000-2016, në mungesë të të dhënave për vitin 2001 u konsiderua vlera e vitit paraardhës (108.000 lekë/vit për person), ndërsa vlera për vitin 2007 është saktësuar sipas shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 27.05.2008, të INSTAT-it, drejtuar ILDKPKI-së (174.072 lekë/vit për person). Në vitin e lindjes së fëmijëve u konsideruan vetëm muajt që nga muaji i lindjes deri në fund të vitit. Sipas kësaj metodike, vlerat e përdorura për shpenzimet jetike janë bazuar mbi të dhënat e Anketës së Buxhetit të Familjes, anketë në të cilën përfshihen edhe shpenzimet për karburant (si pjesë e zërit transport). Për këtë arsye, u krye saktësimi i shpenzimeve të jetesës bazuar në përqindjen (%) që zë zëri transport në totalin e shpenzimeve, përkatësisht 6.3% për vitin 2016.

<sup>60</sup> Me sipërfaqe 82 m<sup>2</sup> dhe vlerë 52.000 euro.

mëtejshëm dhe nën dritën e përdorimit të kësaj pasurie nga subjekti për një periudhë të gjatë kohe [nga viti 2016 deri në 2018 minimalisht] vlerësoi ta konsiderojë atë si marrëdhënie huapërdorjeje, nën dritën e pikës 14, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016. Të njëjtin qëndrim ka shprehur edhe Vëzhguesi Ndërkombëtar gjatë hetimit administrativ nëpërmjet një Opinioni të datës 09.11.2020, duke referuar ekzistencën e arsyeve të bazuara për fshehje të pasurisë nga subjekti dhe sugjeruar që hetimi të kryhet duke cilësuar vjehrrën e subjektit si person tjetër i lidhur, për shkak të marrëdhënies së huapërdorjes.

20.2. Pas administrimit të përgjigjeve të subjektit, Komisioni arriti në përfundimin se sjellja/marrëdhënia e subjektit me këtë pasuri është si të ishte pronar i saj dhe ai gjendet në kushtet e pikës 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Në këtë vlerësim, Komisioni mbajti në konsideratë që subjekti, nuk arriti të provojë: (i) marrëdhënien e vjehrrës dhe kunatit me apartamentin; (ii) burimet e ligjshme financiare të vjehrrës dhe kunatit [vëllai të bashkëshortes] për blerjen e këtij apartamenti; si dhe (iii) nevojën e vjehrrës dhe kunatit për të kryer këtë investim në Tiranë.

20.3. Subjekti i kontestoi konkluzionet e Komisionit në përgjigje të rezultateve të hetimit dhe në vendimin përfundimtar, duke potencuar që denoncimi është i pavërtetë, ndërsa apartamentin e ka përdorur në kuadër të marrëdhënies së mirëbesimit, që nuk përbën shkak për të dyshuar mbi pronësinë e saj. Sipas përfaqësueses së subjektit, edhe në seancën dëgjimore, nuk ka të dhëna që mbështesin dyshimin për fshehje pasurie dhe nuk ka vend për cilësimin e vjehrrës në cilësinë e personave të tjerë të lidhur. Sipas subjektit, duke qenë se e ka deklaruar këtë pasuri në përdorim në deklaratën *vetting*, nuk ka vend për dyshime për fshehje. Në ankim subjekti pretendon që në përlllogaritjen e të ardhurave të kunatit të mbahet në konsideratë një standard jetese prej “një emigranti”, pa shpenzime, përpos atyre minimale.

20.4. Nga analiza e akteve në fashikull, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson që konkluzioni i Komisionit është i drejtë. Në vlerësimin tërësor të rrethanave që rezultojnë nga aktet, edhe në pretendimet e ngritura në ankim, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë se ky apartament nuk përfaqëson pasuri të fshehur të tij. Po ashtu, në kushtet që Komisioni ka hetuar për fshehje pasurie, shtrirja e hetimit mbi këtë pasuri të regjistruar në emër të vjehrrës – pavarësisht nga nëse ka vend kategorizimi i saj sipas nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016 – u vlerësua i drejtë dhe në përputhje me orientimin e Kolegjit për rastet kur hetimi nevojitet të përfshijë pasuri të individëve që *nuk* kategorizohen *persona të tjerë të lidhur*. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

20.5. Pikësëpari, sikurse është arsyetuar gjerësisht më sipër, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë për qartësi që hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri, duke marrë shkas nga denoncimi, u vlerësua i drejtë. Po kështu, edhe hapat që ka ndërmarrë Komisioni për të njohur subjektin me sa ka rezultuar dhe dhënë mundësi atij të japë shpjegime e prova në të kundërtën, u gjetën në përputhje me garancitë procedurale, përfshirë ato për respektimin e parimit të kontradiktorialitetit. Pa përsëritur dhe përpos sa është thënë më sipër, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje që parimi i kontradiktorialitetit nuk nënkupton domosdoshmërisht njohjen me identitetin e denoncuesit, për sa kohë Komisioni kryen hetimin e tij. Sipas jurisprudencës së GjEDNj-së<sup>61</sup>, kontradiktorialiteti në parim, nënkupton mundësinë që palët [në një proces civil ose penal] të njihen dhe të komentojnë për të gjitha provat dhe vërejtjet e depozituara me qëllim që të

<sup>61</sup> *Shih, ndër të tjerë, çështja e GjEDNj-së Vermeulen kundër Belgjikës, para. 33, Dhoma e Madhe.*

kenë ndikim mbi vendimmarrjen e gjykatës. Në rrethanat konkrete, në kushtet kur subjekti është njohur dhe i është dhënë mundësia të kontestojë të gjitha faktet e ngritura nga denoncuesi, të depozitohet provat që ka vlerësuar të nevojshme e më pas gjithë aktet dhe shpjegimet i janë nënshtruar analizës së Komisionit, mosnjohja me identitetin e denoncuesit nuk mund të argumentohet se përbën shkelje të procesit të rregullt.

20.6. Duke iu kthyer analizës së themelit të këtij shkaku ankimi, nga aktet rezulton që sipas kontratës së premtim shitjes për këtë apartament, nënshkruar nga vjehrra e subjektit në datën 19.07.2016, pagesa do të kryhej në këtë mënyrë: 42.000 euro – me nënshkrimin e kontratës; 5.000 euro – me dorëzimin e çelësave; dhe 5.000 euro me nënshkrimin e kontratës së shitjes. Një ditë pas nënshkrimit të kësaj kontrate, më 20.07.2016, nga llogaria e vjehrrës së subjektit është transferuar vlera 42.000 euro në favor të premtues-shitësit të apartamentit. Kjo shumë rezulton të ketë qenë derivat i dy *depozitimeve cash*, respektivisht 35.000 euro në datën 19.07.2016 dhe 7.000 euro në datën 20.07.2016. Transferta e dytë, në vlerën 5.000 euro është kryer më 02.12.2016, po ashtu si derivat i një depozitimi në *cash* në të njëjtën datë. Sipas shkresës së dërguar Komisionit nga banka<sup>62</sup>, vlera 35.000 euro ishte deklaruar si e ardhur nga *shitja e pronës dhe kursime*. Nga ana tjetër, vjehrra e subjektit rezulton të ketë shitur një apartament *dy muaj pas* këtyre transaksioneve e konkretisht në datën 20.09.2016<sup>63</sup>, në vlerën 21.000 euro, ndërsa përfitimi i shumës së plotë nga kjo shitje është deklaruar tre muaj më pas, në datën 20.10.2016<sup>64</sup>.

20.7. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka konfirmuar se vjehrra nuk jeton në Tiranë dhe këtë apartament e ka porositur për djalin e saj, i cili punon dhe jeton në Itali që prej vitit 2001. Nga shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile rezulton se kunati i subjektit [z. A. K.] është martuar në vitin 2015 dhe së bashku me familjen, banon në Bashkinë Berat, Njësia Administrative Nr. {\*\*\*}.

20.8. Në përfundim të hetimit, Komisioni ka konstatuar mungesë burimesh financiare të ligjshme të vjehrrës dhe kunatit të subjektit për blerjen e apartamentit në Tiranë. Komisioni, gjithashtu, ka referuar edhe faktorë të tjerë të cilët i kanë krijuar bindjen që apartamenti i përket subjektit. Konkretisht, Komisioni ka mbajtur në konsideratë që: (i) vjehrra e subjektit nuk ka jetuar asnjëherë në këtë apartament, edhe pse ishte pronare e tij, ndërkohë që subjekti ka jetuar pa ndërprerje në këtë apartament nga nëntori i vitit 2016 deri në prill të vitit 2018, pa kundërshtëpërblim; (ii) vjehrra ka dalë në pension në vitin 1994 dhe ka qenë e punësuar nga muaji dhjetor i vitit 2014 e në vijim me pagë minimale, ndërkohë që ka kryer investime të konsiderueshme në pasuri të paluajtshme, nga viti 2015 e në vijim; (iii) momenti i porositjes duket se përkon në kohë me transferimin e subjektit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë; dhe së fundmi (iv) pavarësisht nga pretendimet e subjektit se porositësi në thelb ishte kunati, ky i fundit nuk rezulton të ketë qenë palë në kontratën e porosisë.

20.9. Në vijim dhe përpos sa arsyetuar më sipër, për sa i përket shkaqeve të ankimit me natyrë procedurale, trupi gjykues rithekson që hetimi i kryer nga Komisioni për indiciet për fshehje pasurie nga subjekti<sup>65</sup> është i bazuar. Ky vlerësim është pasojë e zbatimit në rrethanat faktike konkrete të detyrimit të shprehur në pikën 1, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për deklarimin

<sup>62</sup> Shkresa e ABI Bank, nr. {\*\*\*} prot., datë 21.10.2019.

<sup>63</sup> Sipas kontratës së shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.09.2016.

<sup>64</sup> Deklarata noteriale e vjehrrës së subjektit nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.10.2016.

<sup>65</sup> Paragrafi 5.50/ii, i vendimit të Komisionit.

e pasurive në përdorim, në drejtim të verifikimit të rrethanave që mund të ngrenë dyshime për fshehjen apo paraqitjen në mënyrë të pasaktë të pasurive në përdorim të subjekteve të rivlerësimit<sup>66</sup>. Në të njëjtën kohë, dyshimet për fshehje pasurie krijojnë premisat dhe kanë diktuar hetimin e thelluar nga organet e rivlerësimit, përfshirë edhe Kolegjin<sup>67</sup>, edhe në mungesë të cilësisë së personit tjetër të lidhur, sipas përcaktimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

**20.10.** Për sa më sipër, duke abstraguar nga fakti që ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, në kushtet e rrethanat konkrete cilësimi i vjehrrës së subjektit të rivlerësimit si person tjetër i lidhur nuk përmbush kriteret e përcaktuara nga neni 32, pika 4, trupi gjykues i Kolegjit vëren se për shkak të përdorimit të apartamentit apo dyshimeve për fshehje pasurie, hetimi i kësaj pasurie është i drejtë e i bazuar në Kushtetutë dhe në orientimet e Kolegjit. Kështu që vlerësimin e Komisionit për huapërdorje, sipas nenit 901 të Kodit Civil, Kolegji e vlerësoi pa relevancë, për sa kohë është hetuar për pasuri të fshehur të subjektit. Për këto arsye, ndonëse është i bazuar, pretendimi i subjektit se vjehrra apo kunati nuk mund të marrin cilësinë e personit tjetër të lidhur, nuk përjashton detyrimin e tij për të provuar të kundërtën e konstatimit të fshehjes, përfshirë edhe duke provuar burimet e ligjshme të krijimit të kësaj pasurie.

**20.11.** Në vijim të analizës së mësipërme, Kolegji mori në shqyrtim pretendimet e subjektit në ankim dhe shqyrtoi aktet e sjella prej tij gjatë hetimit administrativ në Komision apo përcjellë me ankimin. Në konkluzion, nga aktet në fashikull, vlerësuar nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit konstaton që subjekti dështoi të provojë edhe në ankim që vjehrra, kunati apo edhe të ardhurat e tyre të ligjshme bashkërisht janë të mjaftueshme për të krijuar apartamentin në Tiranë. Për rrjedhojë, konstatimi i Komisionit është i drejtë. Arsyetimi i trupit gjykues të Kolegjit, mbi të cilin bazohet ky konkluzion, detajohet në vijim.

**20.12.** Si premisa paraprake të kësaj analize, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se në ankim subjekti nuk ka paraqitur pretendime për të provuar mundësinë financiare të vjehrrës për të krijuar pasurinë objekt analize. Për rrjedhojë, analiza e kryer nga Komisioni për të mbeti e pandryshuar dhe pamundësia e saj për të investuar në blerjen e apartamentit në Tiranë u konfirmua edhe nga Kolegji<sup>68</sup>. Po ashtu, subjekti nuk ka dhënë asnjëherë një vlerë specifike për kontributin e kunatit në krijimin e pasurisë. Për këto arsye, analiza e kryer për këtë pasuri u bazua në burimet e paspecifikuara në vlerë e të identifikuar nga subjekti në pyetësorë si burime financiare të krijimit të kësaj pasurie: (i) nga të ardhurat e kunatit të tij nga emigracioni që prej vitit 2001 e në vazhdim

---

<sup>66</sup> Shih, ndër të tjerë, vendimin e Kolegjit (JR) nr. 32/2022, që i përket subjektit A. Balliu, në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit Sh. Kurti [JR nr. 7/2020] dhe në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit F. Islami [JR 10/2022].

<sup>67</sup> Shih, ndër të tjerë, vendimin e Kolegjit (JR) nr. 37/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit B. Lleshi, vendimin (JR) nr. 52/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit N. Tota, vendimin (JR) nr. 30/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit A. Nikolli, si dhe vendimin (JR) nr. 28/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit S. Pani.

<sup>68</sup> Referuar në paragrafët 5.34 dhe 5.52 të vendimit të Komisionit: “[...] për periudhën 1994 – 2016, të ardhurat kanë qenë në shumën 6.116.403 lekë, shpenzimet jetike në shumën 2.551.902 lekë, shpenzime të tjera në shumën 543.460 lekë, shtim i llogarive bankare në shumën 201.753 lekë, shpenzim për blerje apartamenti dhe garazhi në Berat në shumën 6.300.000 lekë (një vit përpara blerjes së apartamentit në Tiranë) dhe shpenzime për blerjen e apartamentit në Tiranë në shumën 6.357.690 lekë”.

Paragrafi 5.52 i vendimit: “[...]jedhe nëse do të konsiderohen në analizën financiare vetëm të ardhurat dhe shpenzimet e jetesës së vjehrrës, duke mos përllogaritur shpenzimin për blerjen e apartamentit në Berat në vitin 2015, shpenzimet për mobilimin dhe shtesat në llogaritë bankare, balanca pozitive do të ishte në vlerën 3.564.501 lekë, pra e pamjaftueshme për pagesën e shumës 47.000 euro (ose 6.357.690 lekë) për porositjen e apartamentit në vitin 2016”.



në Itali e Greqi; (ii) nga shitja e shtëpisë së vjehrrës në Berat (në vitin 2016)<sup>69</sup>; dhe (iii) nga kursimet e vjehrrës nga të ardhurat personale (pension dhe paga).

**20.13.** Nga aktet rezulton se Komisioni i ka përfshirë në analizën financiare të familjes edhe të ardhurat e bashkëshortes së subjektit për periudhën 2002-2005, pavarësisht vlerës së papërfillshme kundrejt vlerës së apartamentit. Kjo nënkupton që ky kërkim është ezauruar. Subjekti, po ashtu, kërkon që të ardhurat e kumatit nga emigracioni dhe shpenzimet e jetesës në Itali, të përlllogariten si: (i) paga mesatare 1.802 euro/muaj – sipas *worldsalaries.org*; (ii) sipas EUROSTAT paga mesatare – 1.736,18 euro/muaj. Subjekti nuk ka sjellë dokumentacion për të provuar të ardhurat e kumatit nga punësimi në Greqi. Për të ardhurat nga punësimi në Itali, Komisioni ka përlllogaritur vitet 2006 – 2015, bazuar në një shkresë ku referohen të ardhurat *bruto*. Në vijim, Komisioni ka konstatuar që, gjithsesi, duke përlllogaritur vetëm shpenzime jetese për një person, kunati i subjektit e ka pasur të pamundur të investonte në krijimin e apartamentit, qoftë edhe për pjesën e balancës negative të burimeve të ligjshme që rezultojnë, pasi u përlllogaritën të ardhurat e ligjshme të vjehrrës së subjektit kundrejt krijimit të kësaj pasurie<sup>70</sup> në vlerën 2.793.189 lekë [balanca negative mes vlerës së apartamentit dhe mundësisë për krijimin e kursimeve].

**20.14.** Edhe në analizën e kryer në Kolegj për këtë aspekt të këtij shkakut ankimi, u konfirmua mungesa e burimeve të ligjshme të kumatit të subjektit për të përballuar edhe pjesërisht apartamentin. Konkretisht, ndonëse të vetmet shpenzime që u përlllogaritën për kunatin kundrejt të ardhurave *bruto*, sikurse ka vepruar Komisioni, janë ato për jetesë, bazuar në të dhënat zyrtare<sup>71</sup>, kunati i subjektit rezulton me një mundësi për kursime në vlerën 12.341 euro në total. Kjo vlerë është e pamjaftueshme të mbulojë balancën negative që rezulton nga të ardhurat e vjehrrës së subjektit në funksion të përballimit të çmimit të apartamentit – referuar më sipër. Duke abstraguuar edhe nga fakti që kjo përlllogaritje është tejet e thjeshtuar apo që Komisioni ka qenë favorizues për këtë aspekt kundrejt subjektit, duke pranuar në cilësinë e provës akte të cilave u mungon forma e kërkuar nga ligji<sup>72</sup> për të ardhurat e kumatit në Itali, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti dështoi të provojë mundësinë e krijimit të pasurisë me të ardhurat e vjehrrës apo kumatit.

**20.15.** Burimi tjetër i identifikuar nga subjekti për krijimin e kësaj pasurie ishin të ardhurat që vjehrra e tij ka gjeneruar nga shitja e një apartamenti, në vlerën 21.000 euro, në vitin 2016, në Berat. Sikurse edhe konstatuar në Komision, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin që ky pretendim i subjektit është alogjik dhe jobindës. Ky burim financiar nuk mund të ketë shërbyer për krijimin e pasurisë objekt analize në kushtet që apartamenti në Berat është shitur në shtator 2016 – dy muaj pasi ishte depozituar shuma 42.000 euro [shih edhe paragrafin 20.6. më sipër] -- ndërsa transaksioni në hyrje i vlerës së fituar prej kësaj shitjeje daton një muaj më pas më 18.10.2016, me përshkrim shterues në transfertën bankare ku blerësit specifikojnë kontratën noteriale të shitjes së këtij apartamenti<sup>73</sup>. Këtë fakt e ka konfirmuar edhe vjehrra e subjektit me një deklaratë noteriale të datës 20.10.2016. Në këto kushte, kronologjia kohore e veprimeve financiare e përjashton tej

<sup>69</sup> Përfitur nga privatizimi pas vitit 1990, shitur më 20.09.2016, në vlerën 21.000 (njëzet e një mijë) euro.

<sup>70</sup> Shih poshtëshënimin nr. 68 më sipër.

<sup>71</sup> Referuar në poshtëshënimin nr. 58 të vendimit të Komisionit, sipas INSTAT-it.

<sup>72</sup> Aktet në fjalë, sjellë në përgjigje të pyetësorit nr. 2, administruar në fashikull, janë fotokopje të thjeshta, të papërkthyer nga gjuha italiane e pa elementë të tjerë të formës zyrtare, si vula apostille.

<sup>73</sup> Në datën 18.10.2016, në llogarinë e vjehrrës së subjektit në ABI Bank janë transferuar 20.999 euro, me përshkrimin “çmim shitjeje sipas kontratës nr. {\*\*\*}, datë 20.09.2016 [...]”, nga blerësi [I. V.] te vjehrra e subjektit [H. K.].

çdo dyshimi mundësinë e krijimit të apartamentit në përdorim të subjektit në Tiranë nga shitja e identifikuar prej subjektit si burim.

**20.16.** Përpos analizës së burimeve financiare, trupi gjykues i Kolegjit, sikurse edhe Komisioni, analizoi një tërësi rrethanash faktike që lidhen me këtë apartament, si premisa të çështjes së ngritur për pasuri të fshehur të subjektit. Nën këtë dritë, me peshë u vlerësua edhe fakti që përveç pasurisë objekt analize vjehrra e subjektit ka blerë disa pasuri të tjera të paluajtshme në vlera të konsiderueshme. Konkretisht, nga aktet rezulton se vjehrra e subjektit, në vitin 2015, bleu apartamentin në Berat me vlerë 6.300.000 lekë dhe garazh me sipërfaqe 20.4 m<sup>2</sup>. Po ashtu, në datën 15.08.2018, ajo ka nënshkruar një kontratë jo noteriale sipërmarrjeje me një shoqëri ndërtuese, për prenotim vendparkimi me sipërfaqe 52.1 m<sup>2</sup> dhe çmim 19.000 euro, pranë apartamentit në Tiranë.

**20.17.** Nga hetimi në Komision, ka rezultuar se vjehrra e subjektit nuk ka automjet të regjistruar në përdorim apo pronësi. Përpos pikëpyetjeve të natyrës financiare që shoqërojnë blerjen e këtyre pasurive, përfshirë edhe pagesat prej 800.000 lekësh dhe 19.000 eurosh brenda një periudhë 3-vjeçare për dy garazhet, ndërkohë që vjehrra e subjektit përfiton të ardhura modeste<sup>74</sup>, fakti që këto shpenzime kryhen për dy garazhe nga një individ që nuk ka automjet dhe nuk përdor as apartamentin dhe as garazhet, ndërsa familja e të birit jeton në Itali e Berat, fakti i mësipërm ngre edhe pikëpyetje të logjikës ekonomike në kryerjen e këtij investimi të konsiderueshëm, nga i cili pronarja duket se nuk vjel asnjë përfitim.

**20.18.** Nga sa më sipër, rezulton që krijimi i kësaj pasurie ka krijuar përfitime vetëm për subjektin e rivlerësimit – në formën e përdorimit të vazhdueshëm. Përkundër këtij fakti, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje mungesën tërësore të ndonjë veprimi që do të lidhte kunatin e subjektit me apartamentin, qoftë edhe në formën e interesimit, kujdesit, pagesës apo negocimit kontraktor, që edhe indirekt do të tregonte lidhje të tij me apartamentin. Pronësia apo interesi i tij financiar nuk gjen asnjë referencë në kontratën e lidhur për shitjen e apartamentit apo porositjen e garazhit, ndonëse në momentin e nënshkrimit të kontratës ai rezulton të ketë qenë në Shqipëri<sup>75</sup>. Referuar vendimit të Komisionit, kunati i subjektit ka udhëtuar dy herë drejt Shqipërisë në vitin 2016, vit në të cilin është prenotuar dhe paguar apartamenti<sup>76</sup>. Me fjalë të tjera, duket jobindëse edhe në këtë këndvështrim përfshirja ekskluzive e vjehrrës në porositjen dhe pagesën e apartamentit, ndërkohë që ai i përkiste apo porositej për kunatin e subjektit, i cili ishte i pranishëm personalisht e fizikisht në këto momente në Shqipëri. Pretendimet e subjektit në proces se aktet i nënshkroi vjehrra që ajo *të ndihej mirë psikologjikisht*, janë deklarative dhe në vijim të sa më sipër, jobindëse. Përkundrazi, në këtë apartament rezulton të ketë qëndruar në mënyrë të vazhdueshme, duke nisur nga momenti i porositjes e deri në transferimin në Durrës, vetëm subjekti, ndërkohë që personi të cilit i atribuohet pasuria, qoftë edhe pjesërisht, nuk e gëzon dhe as evidentohet të ketë kryer ndonjë prej veprimeve që logjikisht priten nga një pronar.

**20.19.** Ndonëse hapat e ndërmarrë për prenotimin e vendparkimit i përkasin vitit 2018, ato paraqitën rëndësi edhe në vlerësimin e Kolegjit, sikurse ka cekur Komisioni në arsyetim, si

---

<sup>74</sup> Nga aktet në fashikull, të ardhurat nga pagat dhe pensioni i vjehrrës për periudhën prill 2015 deri në korrik 2016 janë mesatarisht 35.800 lekë në muaj, ndërsa për periudhën 1994-prill 2015, në total përreth 2.200.000 lekë për 21 vjet ose 8.800 lekë në muaj.

<sup>75</sup> Sipas hetimit të kryer nga Komisioni.

<sup>76</sup> Paragrafi 5.54 i vendimit të Komisionit. <https://kpk.al/wp-content/uploads/2021/02/Vendim-Arben-Allajbeu.pdf>

rrjedhojë e nevojës për të kryer një hetim rigoroz, si parakusht për konkluzionin për pasuri të fshehur të subjektit. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të drejtë konstatimin e Komisionit për përpjekje të subjektit për fshehje të pasurisë në emër të vjehrrës, parashikuar nga pika 5 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016. Sikurse analizuar gjerësisht dhe në detaj, edhe në ankimin në Kolegj, subjekti nuk arriti të provojë se kjo pasuri nuk i përket atij. Ndonëse referenca e Komisionit për këtë pasuri në “Vlerësimin tërësor të çështjes” në faqen 57 është e cunguar, pasi referon nenin 33, pika 5, pjesërisht, ky ometim vlerësohet si gabim material që nuk cenon qartësinë në kushtet që vendimi specifikon në mënyrë të shprehur që subjekti nuk ka provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, ku në mënyrë të shprehur subjektit i ka kaluar barra e provës, pasi është konstatuar përpjekje për fshehje të pasurisë.

20.20. Në përfundim, duke mbajtur parasysh gjithë aspektet e analizuara, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti nuk provoi që pasuria objekt analize në këtë pjesë të arsytimit nuk është pasuri e tij e fshehur. Ndër aspektet e marra në konsideratë, trupi gjykues sjell në vëmendje mungesën e burimeve të vjehrrës apo kunatit për krijimin e kësaj pasurie, mungesën e ndonjë lidhjeje të dokumentuar mes kunatit e pasurisë në fjalë, përdorimin e saj në një kohë të konsiderueshme pa kundërshtim nga subjekti, dinamikën e ngutshme të pagesave, përfshirë edhe nëpërmjet depozitave në *cash* në të njëjtën ditë me shlyerjen e detyrimeve, rezervimin e një posti parkimi në emër të vjehrrës, e cila nuk përdor automjete, investimin e konsiderueshëm të kryer prej saj në vitin 2015 në një pasuri tjetër të paluajtshme, një muaj para se të shiste një apartament tjetër për thujse ½ e çmimit dhe marrëdhënien e ngushtë familjare mes subjektit dhe individit në emër të të cilit figurojnë transaksionet për pagesat e apartamentit. Për rrjedhojë, subjekti gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

## 21. *Për përdorimin e shtëpisë në emër të prindërve në Berat*

21.1. Një ndër aspektet e kontrollit pasuror që ka hetuar Komisioni, e për të cilin subjekti ka ushtruar ankim, është përdorimi prej tij i njërit prej dy kateve të shtëpisë së prindërve, në Berat, në periudhën kohore 2005 – 2014. Për herë të parë, subjekti ka deklaruar këtë marrëdhënie përdorimi në pyetësorin standard, ndërsa në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar si adresë banimi, përfituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes së datës 14.02.1998<sup>77</sup>. Pasi ka konstatuar ekzistencën e dy kontratave të energjisë elektrike në emër të subjektit dhe të atit, lidhur përkatësisht në prill dhe maj 2005, si dhe jetesën e vazhdueshme të subjektit me familjen, përdorimin pakundërshtim të kësaj banese nga subjekti sikurse edhe për shkak të një denoncimi, Komisioni ka vlerësuar që analiza financiare për periudhën kohore 01.01.2004 - 31.12.2014 të kryhet për pasuritë e shpenzimet e tij, personave të lidhur dhe prindërve të subjektit. Në përfundim, Komisioni ka konstatuar se prindërit e subjekti gjenden në kushtet e mungesës së burimeve për investimin në banesën e përdorur nga subjekti në vlerën (-) 2.021.831 lekë. Komisioni, po ashtu, ka vlerësuar se subjekti nuk ka deklaruar saktë apartamentin në përdorim dhe ka mungesë burimesh për ndërtimin, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, gjerat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>77</sup> Nr. {\*\*\*}. - Në Shtator 1993, midis prindërve të subjektit dhe Komisioni i Privatizimit të Banesave, në Berat, është lidhur kontrata sipas ligjit për privatizimin, për shitjen e pasurisë së paluajtshme, në të cilën familja e subjektit të rivlerësimit banonte. Këtë pronë palët e kanë shitur në vitin 1997 në vlerën 700.000 lekë. Shtëpia objekt analize është blerë në vitin 1998, sipas kontratës nr. {\*\*\*}, datë 14.02.1998, në vlerën 1.200.000 lekë.

21.2. Nëpërmjet ankimit, subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit dhe kërkon që pretendimet e tij lidhur me këtë pasuri, të analizohen nën dritën e parimit të proporcionalitetit. Po ashtu, subjekti pretendon se marrëdhënia e përdorimit të shtëpisë së prindërve nuk i kualifikon ata si persona të tjerë të lidhur, referuar jurisprudencës së Kolegjit<sup>78</sup>. Vlera e shpenzimeve të ndërtimit të shtesës së katit, sipas subjektit, duhet të reduktohet nga 3.831.600 lekë, në 2.000.000 lekë<sup>79</sup>. Subjekti kërkoi së fundmi që në përlllogaritje të shtohen të ardhurat nga aktiviteti i shitjes ambulante të nënës për periudhën 2004-2012, nga 131.478 lekë në 616.934 lekë. Përlllogaritja e shpenzimeve të jetesës për vitin 2015 është e gabuar, pretendon subjekti, pasi është dubluar. Nëse do të kryhej një analizë, sipas pretendimeve të tij, vlera negative do të ishte (-) 590.231 lekë, që nuk mund të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

21.3. Nga analiza e akteve në fshikull nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara. Subjekti kishte detyrim të shprehur nga Kushtetuta dhe ligji për të deklaruar pasuritë në përdorim. Po ashtu, bazuar në pikat 12 dhe 13, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, të lidhura me nenin 30 të po këtij ligji, prindërit e subjektit cilësohen *persona të lidhur* me subjektin e rivlerësimit në kushtet që ata kanë qenë pjesë e së njëjtës certifikatë të gjendjes familjare për periudhën tetor 2013 deri në korrik të vitit 2014. Pas kontrollit të analizës së Komisionit, Kolegji konkludon se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur janë gjendur në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të kryer investimin e shtesës së katit të shtëpisë objekt analize, që së bashku me mosdeklarimin e përdorimit e vendosin subjektin në kushtet e parashikuara nga germet “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Arsyeimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

21.4. Sikurse referuar më sipër, subjekti nuk e ka deklaruar përdorimin e kësaj pasurie në deklaratën e rivlerësimit. Në denoncimin që ka shërbyer si indicie për hetim në Komision, është pretenduar se familja e subjektit ka kryer shtesë kati dhe që subjekti ka ndikuar që çështja penale të mbyllet nëpërmjet lidhjeve të tij. Sipas dokumentacionit të përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, investimi i shtesës së katit ka nisur më së paku në muajin tetor të vitit 2013. Me fjalë të tjera, investimi përkon në kohë me periudhën kohore gjatë së cilës subjekti gjendej edhe në të njëjtën certifikatë të trungut familjar me prindërit dhe ka deklaruar se ishte në ekonomi të përbashkët me ta.

21.5. *Së pari*, trupi gjykues i Kolegjit çmon të ndalet në premisën mbi të cilën vijon analiza e kryer për krijimin e kësaj pasurie. Në dritën e përcaktimit të nenit 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016, në kushtet që subjekti rezulton në të njëjtën certifikatë familjare me prindërit deri në vitin 2014, dhe subjekti ka deklaruar jetesë të përbashkët, analiza financiare e pasurive dhe shpenzimeve për subjektin duhet të përfshijë edhe prindërit e tij si *persona të lidhur*. Në rrethanat konkrete, konkluzioni i Komisionit në këtë drejtim – referuar në paragrafin 6.6 të vendimit të Komisionit – është i bazuar në thelb, pavarësisht nga cilësimi i pasaktë i prindërve si persona të tjerë të lidhur. Në kushtet që prindërit nëpërmjet përdorimit të shtëpisë nga subjekti nuk kanë rezultuar huadhënës apo dhurues ndaj subjektit, cilësimi si persona të tjerë të lidhur ka qenë i pabazuar. Për pasojë, bazuar në pikat 12 dhe 13<sup>80</sup>, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, të lidhura me nenin 30 të po këtij ligji,

<sup>78</sup> Subjekti referon vendimin e Kolegjit (JR) nr. 21/2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Roland Jaupaj.

<sup>79</sup> Sipas përlllogaritjeve në tabelën e hartuar nga subjekti në ankim.

<sup>80</sup> Dispozitat në fjalë përcaktojnë si vijon: 12. “Periudha e rivlerësimit” është periudha e punës së subjektit të rivlerësimit, gjatë të cilës vlerësohen aftësitë etike dhe profesionale të tij, sipas këtij ligji. 13. “Person i lidhur” është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin dhe komisionerin publik,

subjekti ka detyrimin të justifikojë burimin e ligjshëm për krijimin e pasurisë objekt analize, edhe duke abstraguuar nga përdorimi i saj në një hark kohor të konsiderueshëm. Meqenëse gjatë kohës që është ndërtuar kati shtesë në vitet 2013-2014, subjekti ka jetuar në kushtet e ekonomisë së përbashkët, në funksion të rivlerësimit, atij i lind detyrimi që të provojë mundësinë financiare për të kryer këtë investim të përbashkët me burime të ligjshme. Ky ka qenë edhe arsyetimi i Kolegjit në çështje në të cilat shtruhej një situatë e ngjashme<sup>81</sup>.

21.6. Cilësimi i prindërve si persona të lidhur ka gjetur zbatim edhe për pasuritë e tjera sipëranalizuar, për të cilat edhe Komisioni, sikurse Kolegji, ka kryer një analizë financiare në të cilën përllogariteshin të ardhurat e përbashkëta të ekonomisë familjare. Në këtë linjë ishte analiza e kryer në Komision dhe konfirmuar në Kolegji për apartamentin në Durrës. Mbi këtë bazë vijon analiza e burimeve financiare të deklaruara nga subjekti e rezultuar nga aktet kundrejt krijimit të kësaj pasurie.

21.7. Subjekti ka kundërshtuar vlerën e investimit të përllogaritur nga Komisioni në ngarkim të ekonomisë familjare, sikurse edhe zëra të tjerë. Pikësëpari, në përgjigje të barrës së provës dhe në seancën dëgjimore, subjekti i kërkoi Komisionit që vlera e përllogaritur si dy kate shtesë të mbajë në konsideratë që punimet janë në gjendje karabina dhe që shtesa përbëhet vetëm nga një kat. Po ashtu, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka deklaruar se janë kryer investime të ndryshme që nga blerja e pasurisë deri në vitin 2014, me vlerë rreth 2.000.000 lekë. Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti ka bashkëlidhur preventivin e materialeve hartuar për babanë e subjektit, që parashikoheshin në një vlerë totale rreth 1.361.000 lekë. Komisioni i ka vlerësuar të pabazuara këto kërkesa dhe ka përllogaritur koston e ndërtimit mbi bazën e udhëzimit të EKB-së për vitin 2013, në qytetin e Beratit, e konkretisht, përrreth 3.800.000 lekë, për një kat shtesë. Komisioni nuk ka reduktuar shpenzimet për gjendje karabina të pretenduar, pasi ka theksuar se jo vetëm që subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor që të përcaktojë vlerën e shpenzuar, por edhe që në kërkesën për legalizim katet shtesë nuk janë deklaruar si karabina.

21.8. Sikurse në Komision, subjekti ka ritheksuar gjendjen karabina të shtesës së katit, cilësim që passjell reduktimin e investimit në vitet 2013-2014 në vlerën 70% të koston së ndërtimit. Po ashtu, subjekti kërkoi në Kolegji të zbritet shumatorja e vlerave që përfaqësojnë TVSh + Fitim + Fond rezerve 25% nga çmimi/m<sup>2</sup>, sipas koston së përcaktuar prej Entit Kombëtar të Banesave. Nga kjo përllogaritje vlera do të ishte 2.011.590 lekë, nga e cila, 5% është kosto pas zbritjes me 25 % të vlerave të TVSh-së dhe fondit rezervë, sipas parashikimit të nenit 12/1 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për kontrollin e disiplinimin e punimeve të ndërtimit". Vlera e investimit e deklaruar në shumën 2.000.000 lekë, sipas subjektit, përputhet me vlerën e përllogaritur në ankim, e që Kolegji duhet ta mbajë në konsideratë. Në mbështetje të këtyre kërtimeve, subjekti ka sjellë vetëm një akt, një preventiv hartuar nga një person juridik për materiale që i janë shitur babait të subjektit dhe nuk ka faturë shoqëruese. Në të nuk ka pasqyrë të volumeve të punës, punimeve të kryera, sipërfaqes, situacionit të punimeve apo të dhëna të tjera të ndërtimit.

21.9. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se përllogaritja e kryer nga Komisioni për vlerën/koston e investimit është e bazuar në akte dhe në harmoni me prova të tjera, duke qenë

---

*i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, komisionerët, gjyqtarët dhe komisionerët publikë për periudhën e rivlerësimit".*

<sup>81</sup> Shih vendimin e Kolegjit (JR) nr. 11/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Ervin Beqiri.

kështu në përputhje me përcaktimin e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016<sup>82</sup>. Në kushtet që mungon specifikim i sipërfaqes së shtesës, Komisioni ka përllogaritur bazuar në sipërfaqen e katit mbi të cilin është mbështetur shtesa (*kati i dytë i ndërtimit*) dhe parametrat e udhëzimit të EKB-së për vitin 2013. Po ashtu, nga aktet e kohës nuk ka referencë për gjendje karabina. Në aplikimin për legalizim, më datë 14.09.2014 [nga babai i subjektit], nuk ka cilësim të shtesës si karabina, sikurse as të dhëna të tjera; koha e ndërtimit vendoset në vitin 2013. I vetmi akt, i cili përmban të dhëna zyrtare të kohës, është vendimi i pushimit të procedimit penal, marrë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, datë 07.04.2015. Në këtë akt, shtesa e katit referohet e ndërtuar “1.5-2 vjet” më herët.

**21.10.** Për rrjedhojë, pretendimet e pambështetura në dokumentacion për të reduktuar vlerën e shpenzimeve mbetën deklarative. Sikurse ka konkluduar Komisioni, përllogaritja për vlerën e ndërtimit, sipas përcaktimit nga EKB-ja, është e drejtë. Edhe në Kolegj, kontrolli i analizës financiare për një kat shtese në vitin 2013 u krye mbështetur në vlerat e përcaktuara nga udhëzimi i EKB-së, sikurse në Komision. Sipas këtij akti -- Udhëzimi nr. 1, datë 08.05.2023, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB, për vitin 2013”<sup>83</sup>, për qytetin e Beratit -- vlera totale për ndërtimin e shtesës së katit është e njëjtë me vlerën e përllogaritur në Komision<sup>84</sup> e konkretisht 3.831.600 lekë [124 m<sup>2</sup> x 30.900 lekë]. Kjo vlerë është konsiderueshëm më e lartë sesa shpenzimi prej 2.000.000 lekësh, pretenduar nga subjekti në ankim. Në funksion të kësaj përllogaritjeje, trupi gjykues i Kolegjit vëren se logjikisht TVSh-ja duket të përfshihet, pasi ajo përbën një tarifë që shoqëron shitjen e materialeve. Për rrjedhojë, edhe në Kolegj konfirmohet mungesa e burimeve të ligjshme të subjektit dhe personave të lidhur, në vlerën e konstatuar nga Komisioni për të kryer këtë investim.

**21.11.** *Së dyti*, një zë tjetër i analizës financiare që konteston subjekti në ankim janë të ardhura që ai pretendon se janë krijuar nga aktiviteti i shitjes ambulante që ka ushtruar nëna e tij, nga viti 2004 deri në vitin 2011. Komisioni ka pasqyruar në analizën financiare vetëm të ardhurat e referuara në shkresën e Bashkisë Berat, nga viti 2012, që përkon me kohën kur ka aktivitet të regjistruar pranë institucioneve. Komisioni nuk e ka marrë në konsideratë këtë kërkim për të ardhurat e pretenduara nga subjekti për periudhën 2004-2011, qoftë për ushtrimin e aktiviteti apo edhe për ekzistencën e të ardhurave të tatueshme, në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

**21.12.** Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues për të provuar ushtrimin e këtij aktiviteti apo sasinë e të ardhurave të pretenduara të krijuara nga e ëma për periudhën kohore 2004-2011. Ndërsa për periudhën kohore të viteve 2004 – 2014, përpos atyre të konfirmuara nga pensioni, ai pretendoi se sipas ligjit të kohës, në periudhën 2007-2013, tatimpaguesit me xhiro faktike nën vlerën 2.000.000 lekë nuk kishin detyrim të dorëzonin deklaratë vjetore tatimesh. Në ankim, subjekti pretendon se ai gjendet në pamundësi objektive për të disponuar dokumentacion që justifikon ligjshmërinë e krijimit të të ardhurave nga nëna e tij si shitëse ambulante për fruta-perime, sepse “nuk ka dokumentacion të ruajtur në

---

<sup>82</sup> Neni 49, pika 4 parashikon që: “[...] Komisioni dhe Kolegji i Apelit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes. [...]”.

<sup>83</sup> [https://ekb.gov.al/wp-content/uploads/2015/07/Udhëzim\\_1\\_08-05-2013.pdf](https://ekb.gov.al/wp-content/uploads/2015/07/Udhëzim_1_08-05-2013.pdf)

<sup>84</sup> Konkretisht, kostoja për vitin 2013 në Berat përllogaritet 30.900 lekë/m<sup>2</sup>. Në këtë kosto, sipas Udhëzimit, nuk përfshihen vlerat e: (1) rrjetit inxhinierik; (2) projektit; (3) studimit gjeologjik dhe sizmik; (4) lejes së ndërtimit; (5) truallit; dhe (6) shpenzimeve operacionale të EKB-së 4%.

institucionet shtetërore”, sipas tij. Sipas tabelës së paraqitur në ankim, të ardhurat e fituara nga e ëma në periudhën 2004 – 2012 janë në vlerën 616.934 lekë.

**21.13.** Nga aktet në fashikull, analizuar nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit vëren se analiza e kryer në Komision është e bazuar. Në kushtet që aktiviteti privat i nënës së subjektit dokumentohet duke nisur nga viti 2012, me regjistrimin në QKB-së<sup>85</sup>, pretendimi i subjektit është deklarativ. Interpretimi ligjor i potencuar nga subjekti është i pabazuar dhe i cunguar, pasi duke filluar nga viti 2006, përjashtimi nga tatimi i thjeshtuar, sipas nenit 32/1 të ligjit nr. 8438/1998<sup>86</sup>, nuk përjashtonte shitësit ambulantë nga detyrimi i pagimit të taksave vendore. Sipas nenit 9, pika 1 e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”<sup>87</sup>, “[...] Në taksat vendore përfshihen: 1. Taksa vendore mbi biznesin e vogël [...]”. Në Aneksin nr. 5 të këtij ligji parashikohet i kualifikuar si subjekt i biznesit të vogël me nivelin tregues të taksës, edhe shitësi ambulant. Për rrjedhojë, subjekti do të duhet të kishte provuar, më së paku, se nëna e tij ishte regjistruar, hap pas së cilit, sipas të njëjtit ligj<sup>88</sup>, do të ishte pajisur edhe me certifikatë regjistrimi nga bashkia. Në kushtet që Bashkia Berat ka referuar regjistrimin si person fizik në emër të nënës, vetëm duke filluar nga viti 2012 e për një aktivitet tjetër, pretendimet e subjektit për pamundësi objektive janë jobindëse, përveçse të paprovuara, sipas gjuhës taksative të nenit 32, pika 2, që normon rastet kur mund të parashtrahet ky pretendim dhe mënyrën sesi veprojnë organet e rivlerësimit. Konkretisht, në asnjë nga shkresat e sjella nga subjekti, nuk rezulton të referohet zhdukje, humbje apo pamundësi për të gjeneruar të dhëna. Përkundrazi, shkresa e Bashkisë Berat e marsit 2021 – pasi subjekti është njohur me vendimin e Komisionit -- edhe duke abstraguuar nga papranueshmëria e saj për shkak të ndalimit nga neni 47 i ligjit nr. 49/2012, për rastet përjashtimore të sjelljes së provave të reja në ankim, pasqyron thujtë në mënyrë identike interpretimin e parashtruar nga subjekti, duke u fokusuar në mungesën e detyrimit për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin, ndërkohë që mungon të shprehët për sa rezulton nga detyrimet ndaj organeve të pushtetit vendor. Me fjalë të tjera, kjo shkresë nuk qartëson pyetjen nëse ka pasur certifikatë regjistrimi nga bashkia dhe/ose nëse prova të tilla nuk janë ruajtur apo mbledhur nga ai institucion. Këto akte, po ashtu, nuk shpjegojnë bindshëm përse ka të dhëna lehtësisht të disponueshme e gjenerueshme për aktivitetin tjetër, duke filluar nga viti 2012, por jo për vitet e mëhershme.

**21.14.** *Së treti*, për sa i përket themelit të këtyre pretendimeve e konkretisht përlllogaritjes së një vlere të ardhurash që, sipas subjektit, prindërit e dispononin në saje të aktivitetit tregtar të nënës, duke e gjetur qasjen e Komisionit të bazuar, trupi gjykues i Kolegjit konfirmoi të njëjtat të ardhura në kontekstin sasior. Në kushtet që për periudhën e mëhershme nuk ka dokumentacion qoftë edhe rrethanor për ekzistencën e aktivitetit, vlera e pretenduar nga subjekti është thjesht deklarative e paprovuar me asnjë dokumentacion. Kjo situatë përjashton edhe analizën për ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, sipas nenit D, pika 3<sup>89</sup> dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte,

---

<sup>85</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 28.10.2019.

<sup>86</sup> Kjo dispozitë parashikonte, ndër të tjera, që: “[...] Përjashtohen nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin ambulantët në fushën e tregtisë dhe të shërbimeve [...]”.

<sup>87</sup> <https://arkiva.financa.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/8.pdf>

<sup>88</sup> Neni 12, pika 5: “Bashkia ose komuna pajis me certifikatë regjistrimi çdo taksapagues, i cili ka përfunduar procesin e regjistrimit ose të reregjistrimit, në përputhje me udhëzimin. Në certifikatë shënohen numri i identifikimit të taksapaguesit, lloji i veprimtarisë dhe adresa e vendndodhjes së biznesit. Numri i identifikimit është unik, në shkallë kombëtare dhe përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave, sipas nenit 4 të këtij ligji”.

<sup>89</sup> “[...]Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj [...]”.

përrjashtohet edhe mundësia që nëpërmjet pagesës së detyrimeve tatimore e taksave vendore, në procesin e rivlerësimit të mund të përlllogaritej një vlerë e fituar.

21.15. Konkluzioni i mësipërm mban në konsideratë që sipas akteve shkresore të administruara në Komision nga QKB-ja, Bashkia Berat dhe administrata tatimore të dhënat për të ardhura të përfituara nga aktiviteti tregtar i nënës së subjektit apo shlyerjes së detyrimeve tatimore, datojnë duke filluar nga janari 2012. Nga shkresa e QKB-së referohet objekt veprimtarie “*Tregti me pakicë të librave (Bar Lokal)*”. Edhe shkresa e Bashkisë Berat, datë 22.10.2020, konfirmon se nëna e subjektit, në cilësinë e personit fizik, për *tregti me pakicë të librave*, për vitet 2012-2013 është konsideruar se ka pasur qarkullim vjetor 0 - 2 milion lekë, duke u aplikuar vlerat tatimore, sipas këtij qarkullimi. Ndërsa nga shkresa e Drejtorisë së Arkivit të Institutit të Sigurimeve<sup>90</sup>, rezulton se nga data 01.02.1966 deri më datë 22.07.1987, nëna e ndjerë e subjektit ka qenë e punësuar në profesione të ndryshme (*tezgjahiste, arsimtare, shitëse dhe seleksionuese*), ndërsa duke filluar nga viti 1992 ka përfitur pension. Rezultoi, gjithashtu, që nga viti 2012 deri në 2014, nëna e subjektit ka derdhur edhe kontribute mujore sigurimesh shoqërore<sup>91</sup>.

21.16. Nga leximi në harmoni i këtyre akteve, rezultojnë të ardhura të nënës nga *pension* deri në vitin 2012 dhe nga një *aktivitet tregtar* i ndryshëm nga ai i shitëses ambulante, pas vitit 2012. Në këtë linjë, edhe analiza financiare e kryer në Komision e konstatuar e drejtë nga Kolegji përfshiu të ardhurat që konfirmohen nga këto akte. Ky qëndrim është në linjë edhe me qasjen e Kolegjit në vendime të mëparshme që kanë analizuar pretendime të subjekteve për përfshirje të ardhurash nga aktiviteti si shitës ambulante<sup>92</sup>.

21.17. Në përmbledhje të sa më sipër, pas kontrollit të analizës së Komisionit, Kolegji konkludon se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur janë gjendur në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të kryer investimin e shtesës së katit të shtëpisë objekt analize, që së bashku me mosdeklarimin e përdorimit e vendosin subjektin në kushtet e parashikuara nga germa “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

## 22. Analiza financiare 2014 – 2017

22.1. Subjekti ka përfshirë nën shkakun e mësipërm të ankimit (analizuar nën paragrafin 21) edhe pretendime që duket se i referohen një prej konkluzioneve të Komisionit, që i përket analizës financiare për këto tri vite. Në kushtet që konkluzioni të cilit i përket këto pretendime është rubrikë më vete e i përket paragrafit 10 dhe në konkluzionet tërësore të faqes 57 si pika 6, trupi gjykues i Kolegjit në vijim analizoi këto pretendime sikurse në vendim, për lehtësi strukturore. Konkretisht, pasi ka analizuar këto vite, Komisioni ka konstatuar mungesë burimesh të ligjshme të subjektit në vlerën (-) 490.051 lekë, për të përballuar shpenzimet dhe krijuar *kursimet cash* në vlerën 450.000 lekë nga pagat e vitit 2015.

22.2. Subjekti pretendon se Komisioni kryen vlerësim të gabuar të shpenzimeve të jetesës, pasi ndonëse standardi i përdorur nga INSTAT referon vlerën 897.104 lekë si maksimum, për vitin 2015, për shpenzimet e familjes së tij është vendosur një vlerë prej 1.519.905 lekësh. Disa zëra, sipas tij, janë të përfshirë në standardin e anketës e nuk duhet të pasqyrohen më vete. Po ashtu,

<sup>90</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 28.10.2019, “Vërtetim për vjetërsinë në punë për efekt pensioni” dhe vërtetimi nr. {\*\*\*} prot., datë 08.06.2020, për masën e pensionit.

<sup>91</sup> Shkresa e DRSSh, Berat nr. {\*\*\*} prot., datë 09.07.2020, “Vërtetim për bazën e vlerësuar”.

<sup>92</sup> Ndër të tjerë, vendimi i Kolegjit (JR) nr. 17//2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Rozeta Qirjaqi.



subjekti rithekson edhe faktin që analiza financiare për këtë vit duhet të pasqyrojë faktin që njëri nga fëmijët e tij ka përfituar shërbime nga shkolla në vitin 2015 (arsimor, transport dhe ushqim).

22.3. Arsyetimi për pretendimin që lidhet me përfitimet e fëmijëve nga shkolla është analizuar gjerësisht më sipër. Pretendimet e tjera për vitin 2015, në vlerësimin e trupit gjykues janë po ashtu të pabazuara. Përpos sa është arsyetuar gjerësisht më sipër për standardin *minimal jetik* që përfaqësojnë shpenzimet e jetesës sipas INSTAT, sikurse arsyetuar edhe nga Komisioni referuar publikimit të atij institucioni<sup>93</sup>, ky pretendim i subjektit bie ndesh me sa rezulton nga aktet për shpenzime të dokumentuara të kryera prej subjektit e familjes së tij, e që nuk mund të argumentohet se janë pjesë e të njëjtës paketë/standardi minimal, në kushtet që i përgjigjen zgjedhjeve financiare të tij e familjes së tij.

22.4. *Së pari*, shifrat e referuara nga subjekti në ankim për shpenzimet e jetesës duket të jenë marrë nga analiza financiare e përcjellë nga Komisioni me rezultatet e hetimit, si Aneksi 1. Me fokus në vitin 2015, që është edhe shembulli i marrë prej subjektit në ankim, shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur nga Komisioni në vlerën 897.104 lekë. Nga ana tjetër, shuma e referuar prej subjektit si “Shpenzime jetese”, 1.519.905 lekë, është shumatorja e *gjithë* shpenzimeve të atij viti. Në atë shumë, përveç shpenzimeve bazike të jetesës, janë përfshirë shpenzimet e konfirmuara nga dokumentacioni të kryera gjatë vitit, e konkretisht: shpenzime për shlyerje kredie (interesa & principal), shpenzime udhëtimi jashtë shtetit (sipas bazës së të dhënave të Policisë Kufitare) përlllogaritur sipas metodologjisë garantiste të përcaktuar në jurisprudencën e Kolegjit<sup>94</sup>, si dhe shpenzime administrative për automjetin. Për sa më sipër, subjekti argumenton që ndonëse nga aktet rezultojnë shpenzime specifike të identifikueshme dhe të konsiderueshme për vitin në analizë, që përkojnë me një stil jetese të caktuar – shpenzime për një apartament në bregdet, i cili nuk përdoret për banim të përditshëm [sikurse deklaruar prej tij, referuar më sipër], udhëtime jashtë shtetit dhe automjet – ato të mos merren në konsideratë si të kryera prej tij e familjes, duke përlllogaritur një standard që përkon me emëruesin e përbashkët më modest që përfaqësojnë shpenzimet bazike të përdorura si referencë nga organet e rivlerësimit, sipas anketimeve të INSTAT.

22.5. *Së dyti*, pa përsëritur sa është arsyetuar më sipër e në vendime të mëparshme, edhe në këtë rast, trupi gjykues i Kolegjit rithekson qëndrimin e konsoliduar për këtë çështje për të përlllogaritur si shpenzime vjetore ato minimale të referuara nga INSTAT për jetesën. Pavarësisht se magjistratët përfitojnë paga më të larta, krahasuar me shumicën e fashave demografike të cilat ka në fokus ky standard, trupa të ndryshëm në Kolegji kanë përlllogaritur vetëm shpenzime minimale jetese sipas INSTAT, në rastet kur mungon dokumentacion apo deklaram nga subjektet për shpenzime të tjera. Nga ana tjetër, shpenzimet e tjera që rezultojnë nga aktet apo deklarohen nga subjektet përfshihen në analizë, pasi janë të konfirmuara apo përkojnë me nevojat e zgjedhjet ekonomike të identifikueshme të subjekteve të ndryshme. Diferenca mes këtyre kategorive shpenzimesh është e tillë që, ndërsa në anketimin mbi të cilin bazohet INSTAT, në vitin 2015, shpenzimet e transportit zënë 6.8% të shpenzimeve të jetesës, shpenzimet e udhëtimit të konfirmuara të subjektit përbëjnë

---

<sup>93</sup> Shih poshtëshënimin nr. 111 të vendimit, referuar INSTAT-it, Manualit të Anketuesit, që referon drejtpërdrejt “monitorimin e varfërisë” dhe Strategjisë së Qeverisë Shqiptare për Rritjen Ekonomike dhe Reduktimin e Varfërisë.

<sup>94</sup> Faqe 26-28 e vendimit nr. 11/2019, <https://kpa.al/wp-content/uploads/2019/07/E-Islamaj-vendim-i-anonimizuar-p%C3%ABr-web.pdf>.

36% të shpenzimeve të jetesës për vitin 2015 dhe 22% në vitin 2016. Nga ana tjetër, shlyerja e kredive nuk ekziston si shpenzim për konsum i Njësisë Ekonomike Familjare.

22.6. Me fjalë të tjera dhe në vijim të analizës së mësipërme, kërkesa për mospërfshirje të shpenzimeve që rezultojnë nga aktet është e pabazuar e përbën një pretendim inkonsistent me stilin e jetesës që rezulton nga investimet e kryera nga subjekti. Nga kontrolli i kryer në Kolegj për vitin 2015, balanca negative zvogëlohet në vlerën (-) 315.914 lekë, pasi u reflektuan korrigjime që derivojnë nga saktësimi i pagave. Pavarësisht nga ky korrigjim, subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme, sipas përcaktimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

23. *Kursimet 900.000 lekë cash, të deklaruara në deklaratën vetting*

23.1. Komisioni ka konstatuar se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, në kundërshtim me germën “a”, të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, për të krijuar kursimet në vlerën prej 900.000 lekësh në gjendje *cash*, të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, pasi kjo vlerë nuk përputhet me deklaramet e subjektit në deklaratat periodike. Pasi subjekti sqaroi në pyetësorin nr. 3 se deklaramet janë shtesa të gjendjes *cash*, në pyetësorin nr. 4, pyetur për diferencën prej 470.000 lekësh midis gjendjes së likuiditeteve *cash* në datën 31.12.2016 (1.370.000 lekë) dhe në datën 26.1.2017 (900.000 lekë), deklaroi se në deklaratën e pasurisë *vetting* i është referuar vetëm gjendjes së kursimeve të krijuara që nga momenti i marrjes së detyrës në datën 14.07.2014 e në vijim. Sipas analizës së Komisionit, edhe nëse do të konsiderohej bindës ky shpjegim, subjekti duhet të shpjegonte diferencën prej 470.000 lekësh, që rezulton midis deklaramit në deklaratën periodike të vitit 2016 dhe deklaratës së pasurisë *vetting*. Pas analizës, Komisioni ka konkluduar për pasaktësi, si referuar më sipër.

23.2. Subjekti pretendon në ankim se konkluzioni i Komisionit, për deklaram të pasaktë të gjendjes *cash*, nuk mund të përbëjë shkak për shkarkim nga detyra, pasi këto pasaktësi nuk janë shoqëruar me përpjekje për të fshehur pasurinë. Po ashtu, subjekti pretendon se *pasaktësitë* nuk mund të konsiderohen *si deklaram i rremë*, dhe nuk mund të përbëjë shkak për t’u shkarkuar nga detyra. Sipas subjektit, për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, duhet të përmbushen në mënyrë *kumulative* pamjaftueshmëria në kriterin e kontrollit të figurës dhe në kriterin e pasurisë.

23.3. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se pretendimet e sipërreferuara bazohen në një interpretim të gabuar të dispozitave kushtetuese e ligjore që gjejnë zbatim. Sjellim në vëmendje që masa disiplinore për subjektin është marrë nga Komisioni pasi ka konstatuar probleme me *disa* prej pasurive të marra në analizë, sikurse edhe disa situata ligjore të përcaktuara nga neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Konkretisht, vendimi referon deklaram të pasaktë, mungesë burimesh të ligjshme, fshehje pasurie ose tre nga pesë situatat ligjore që përcakton neni 33, pika 5 e këtij ligji. Për shkak të këtyre problematikave, Komisioni ka konkluduar me nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për deklaram të pasaktë e që subjekti nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë. Përkundër këtyre konkluzioneve, fokusimi i argumenteve të subjektit në faktin që vendimi objekt ankimi nuk përmban deklaram të rremë apo që ai nuk është përpjekur të fshehtë pasurinë tregon një argumentim të cunguar e alogjik në pretendimet e tij.

23.4. Në të njëjtën linjë, interpretimi i potencuar nga subjekti se nevojitet të konstatohet deklaram i pasaktë në dy kritere si parakusht për shkarkimin është po ashtu rezultat i një interpretimi që nuk mban në konsideratë leximin harmonik të Aneksit të Kushtetutës e ligjit nr. 84/2016. Sikurse është zbërthyer gjerësisht në vendime të tjera të Kolegjit, normat kushtetuese e ligjore, të cilat

parashikojnë situatat që sjellin aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit, në përcaktimet e pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, janë autonome. Ato përkojnë përgjithësisht me dispozita të caktuara e autonome të Aneksit të Kushtetutës. Në varësi të rrethanave konkrete, secila prej tyre mund të passjellë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, porë në kuptim të deklarimit të pamjaftueshëm, sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Ky i fundit, ka përcaktuar gjashtë (6) situata të cilat mund të passjellin masën disiplinore të shkarkimit, e konkretisht: që subjektet e rivlerësimit duhet të shpjegojnë bindshëm se nuk gjenden në kushtet e dyfishit të pasurisë së ligjshme, nuk kanë kontakte të papërshtatshme, nuk kanë kryer deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë, nuk kanë kryer deklaram të pamjaftueshëm të kontrollit të figurës, janë të aftë profesionalisht, si dhe me sjelljet dhe veprimet e tyre nuk kanë cenuar besimin e publikut te drejtësia.

23.5. Ky pretendim është trajtuar gjerësisht në praktikën e Kolegjit<sup>95</sup>, në zbrërthim të interpretimit të autonomisë së dispozitave kushtetuese e ligjore, cekur më sipër. Në mënyrë të konsoliduar, trupa të ndryshëm gjykues të Kolegjit kanë konfirmuar se Kushtetuta e ligji nuk përcaktojnë se si parakusht për masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, plotësimin në mënyrë kumulative të disa kritereve, dritën e parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, rezulton qartë që mjafton të gjendet e plotësuar një prej kushteve të parashikuara në njërin prej pikave për të passjellë dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra<sup>96</sup>. Ky qëndrim përforcohet edhe nga qëndrimi i mbajtur nga GjEDNj-ja, në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*<sup>97</sup>, që hedh poshtë pretendimet e subjektit se shkaqet e shkarkimit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative.

23.6. Në përmbledhje e si konkluzion i arsytimit më sipër, rezulton se interpretimi mbi pretendimin e subjektit të rivlerësimit është i pabazuar në ligj. Subjekti nëpërmjet tij, jo vetëm parashtron interpretime të pambështetura në ligji, por tenton të sjellë një interpretim të ndryshëm nga parashikimet e pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, duke u fokusuar vetëm te fshehja apo deklarimi i rremë. Për të njëjtin argument, edhe pretendimet e subjektit, që lidhen me gjendjen ose jo në kushtet e dyfishit të pasurisë dhe se *pasaktësitë, nuk mund të konsiderohen si deklarim i rremë*, për t'u shkarkuar nga detyra, rezultojnë të pabazuara. Në të njëjtën linjë, është i pabazuar pretendimi i subjektit që pamjaftueshmëria e deklarimit duhet të shoqërohet domosdoshmërisht me deklarim të rremë për kriterin e figurës apo që deklarimi i pamjaftueshëm nënkupton sjellje “në nivel kundërligjshmërie” të renditur në pikat 1, 2, 4 dhe 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Moskalimi me sukses, qoftë edhe i njërit nga kriteret, është shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 94/2016. Sipas kësaj dispozite, vendimi mund të merret në bazë të një apo disa kritereve.

23.7. Kolegji mori në analizë edhe themelin e këtij shkaku ankimi, e konkretisht pretendimet që lidhen me konkluzionin e Komisionit për pasaktësi të deklarimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, të *cash*-it jashtë sistemit bankar. Komisioni ka konstatuar se, ndërsa në deklaratën periodike vjetore për vitin 2016 – që mban datën 29.03.2017 – nga përlllogaritja e vlerave *cash* të deklaruara prej subjektit ndër vite, rezulton një total në vlerën 1.370.000 lekë, në deklaratën *vetting*, plotësuar dy

---

<sup>95</sup> Shih, ndër të tjerë, vendimin e Kolegjit (JR) nr. 19/2019, që i përket subjektit të rivlerësimit *Xhezair Zaganjori dhe vendimin e Kolegjit (JR) nr. 11/2021, që i përket subjektit të rivlerësimit Ilir Mustafaj.*

<sup>96</sup> Shih vendimit të Kolegjit (JR) nr. 32/2022, që i përket subjektit të rivlerësimit *Arjan Balliu, parag. 21.1.*

<sup>97</sup> 412. [...] Gjykata konstaton se është në përputhje me frymën e procesit të rivlerësimit që të ketë një shkallë më të kufizuar sanksionesh, në rast se një person nuk arrin të përmbushë një nga tri kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 84/2016.

muaj më herët, më 26.01.2017, subjekti ka deklaruar 900.000 lekë *cash*. Në përgjigje të pyetjeve të Komisionit për deklarimet periodike të likuiditeteve jashtë sistemit bankar (*cash*) ndër vite, subjekti është shprehur se vlerat përbëjnë shtesa, ndërsa në deklaratën *vetting* ka deklaruar vlerën e të ardhurave *cash* “të siguruara nga koha e marrjes së detyrës.” Po ashtu, subjekti, më tej, është shprehur se në deklaratën e pasurisë *vetting* nuk ka përfshirë një shumë prej 400.000 lekësh, fituar para fillimit të detyrës. Sipas tij, kuptimi i ligjit nr. 84/2016 ishte deklarimi i *cash*-it nga fillimi i detyrës e më pas. Komisioni ka theksuar që kuptimi i pasaktë i ligjit nuk e shkarkon subjektin nga përgjegjësia e ka konkluduar me pasaktësi në deklaratën *vetting*.

23.8. Nga analiza e akteve në fashikull nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim dhe përpos sa është shtjelluar më sipër për aspekte të tjera të këtij shkak ankimi, trupi gjykues i Kolegjit vëren se është i bazuar konstatimi i Komisionit. Subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting*, në kundërshtim me përcaktimin e germës “a”, të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë konkluzion, trupi gjykues mban në konsideratë që objekti i deklarimit, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016 dhe Udhëzimit nr. 4095/2016, përcakton qartësisht se në deklaratën e pasurisë *vetting* duhet të deklarohen të gjithë likuiditetet që janë akumuluar *deri në ditën* e plotësimit të deklaratës. Kufiri kohor “pasi ka filluar detyrën”, që parashtron subjekti në mbështetje të pasaktësisë së konstatuar, nuk gjen mbështetje në asnjë formë në ligj apo në aktet nënligjore e në udhëzimet e shprehura të formularit që pasqyrohet në Shtojcën 2. Për më tepër, edhe nëse do të pranohej logjika e prezantuar nga subjekti, si shkak për diferencën e vlerave, e konkretisht, duke mos përfshirë vlerën 400.000 lekë, të deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës, përsëri subjekti do të rezultonte me një diferencë të pajustificuar prej 70.000 lekësh, në deklaratën *vetting*. Në kuptim të ligjit nr. 84/2016, edhe kjo diferencë, ndonëse në vlerë të ulët, e bën të pasaktë deklarimin në deklaratën *vetting*. Për sa më sipër, Kolegji çmon se deklarimi i subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting*, më së paku, është i pasaktë. Sikurse ka theksuar Komisioni, kuptimi i pasaktë i ligjit nuk mund të përbëjë argument të pranueshëm. Ky ka qenë edhe qëndrimi i Kolegjit në çështje të mëparshme<sup>98</sup>. Në këto kushte, Kolegji e gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti nuk e ka deklaruar saktë gjendjen *cash* në deklaratën e pasurisë *vetting*, sipas germës “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

24. Nga verifikimi i fashikujve të hetimit administrativ, lidhur me pretendimet në ankim për analizën financiare, siç është analizuar në këtë vendim, Kolegji kreu disa korrigjime të analizës financiare të Komisionit. Pavarësisht këtyre korrigjimeve, përpos problematikave të konstatuara për pasuritë e analizuar, subjekti i rivlerësimit rezultoi, gjithsesi, me balancë negative të konsiderueshme për periudhën e analizuar.
25. Përfundimisht, pasi analizoi pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim dhe në parashtrime, shqyrtoi provat shkresore të administruara në dosjen hetimore të kësaj çështjeje, bazuar në konkluzionet e mësipërme, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit Arben Allajbeu nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë. Nën dritën e pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë e të pamjaftueshëm dhe të fshehjes së pasurisë.

---

<sup>98</sup> *Shih, ndër të tjerë, vendimin e Kolegjit (JR) nr. 19/2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Xhezair Zaganjori.*

26. Për sa më lart, vendimi nr. 334, datë 14.01.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

**PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në germën “a”, të pikës 1, të neni 66 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

**VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 334, datë 14.01.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Arben Allajbeu.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 21.11.2023.

**ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

**RELATORE**

**Rezarta SCHUETZ**

**KRYESUESE**

**Ina RAMA**